

PROCESVERBALI

Nga mbledhja XI-të e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 26.10.2018, duke filluar nga ora 10:20, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm 37 anëtarë.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja, Zyra e EULEX-it, KFOR-it dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Artan Abrashi, kryesues.

Për këtë mbledhje janë paraparë këto pika për:

R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28 shtator 2018;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës së propozuar;**
- 3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i kartës së qytetit të Prizrenit;**
- 5. Diskutimi për Raportin financiar të Komunës së Prizrenit për periudhën janar-shtator 2018 dhe**
- 6. Shqyrtimi– diskutimi për propozimvendimin për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës pyjore.**

Pika e parë:

Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të datës 28 shtator 2018;

A ka dikush të shtoj rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Kastriot Krasniqi (PDK): Sa i përket procesverbalit kërkoi që të jenë më të kujdesshëm, sepse fjalët i shkurtojnë dhe nuk i citojnë ashtu siç duhen. Edhe në CD e ke të njëjtën. Po ashtu edhe gjysma e fjalëve që kam fol atë ditë mungojnë në procesverbal.

Kryesuesi: Më vërejtjen që u dha nga anëtari i Kuvendit, këtë procesverbal e hedh në votim. 36 anëtarë janë prezent në sallë, kush është për?

Për? – Të gjithë.

Kundër? – S'ka.

Abstenim?- S'ka.

Atëherë konstatoj se me 36 vota kalon procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës të propozuar.

A ka dikush të shtoj diçka rreth rendit të ditës. Nëse nuk ka, 36 anëtarë jemi në sallë, e hedh në votim këtë rend dite, kush është për?

Për? – 35.

Kundër? – 1.

Abstenim? – S'ka.

Atëherë konstatojë se me 35 vota për 1 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet rendi i ditës i propozuar.

Pika e tretë:

Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.

Sadije Osaj Jakupi (LDK): Kërkoj që dita e enjte të kthehet si ditë e mbajtjes së seancës, meqenëse ne jemi gati të gjithë të punësuar në arsim. Arsyeja është se oraret tona janë bo gati në shtator. Pyetja tjetër i drejtohem Zyrës së Personelit. Si qëndron çështja tash me gradimin e pozicioneve të punëtorëve, ku në institucione ka raste kur punëtorët me përgatitje e me pozita të njëjta, të punës së njëjtë, gradohen në forma të ndryshme. Për shembull koeficienti gjashtë, bëhet të njëri nëntë, të tjetri dhjetë dhe njëmbëdhjetë. Koeficienti pesë në disa raste bëhet dhjetë, njëmbëdhjetë. Po më vjen keq, por do të fillon kjo të implementohet. Do të ketë pakënaqësi të punëtorëve, që nuk dihet se si do ta shprehin këtë. Andaj, a ka mundësi për hir të transparencës, me prezantua listën për secilin punëtor të administratës. Dhe se çfarë koeficienti keni propozua për secilin punëtorë të administratës, të prezantohen para qytetarëve. Kam një kërkesë gjithnjë duke u bazuar dhe duke u thirrur në ligj. Kërkoj që në çdo drejtori të çdo fushe, me fillua me mbledh të dhëna në baza gjinore. E di që jemi pak të vonuar. E di që kërkon analizë dhe staf të trajnuar. Por vetëm kështu me projekte do të fuqizohen kuadrot tona. Jemi dakordua me KDI-n dhe me grupin e grave kuvendare, që me shty çështjet e grave në nivel lokale. Si çështje e parë, ndërtimi i çerdheve ishin në premtime. Dhe në këto

çerdhe nënat vetushqyese të lirohen nga pagesa. Sepse do të kyçen në tregun e punës. Dhe gjendja ekonomike do të ju rregullohet. Në ekzekutiv kemi vetëm një femër. Ne si gra kuvendare dhe me gratë e shoqërisë civile do të ndërmarrim iniciativat për barazim, sepse nuk kemi aspak përfaqësim gjinor.

Illir Baldedaj (AAK): Fatkeqësi e madhe është që në asnjë seancë kryetari i komunës nuk vjen. Sepse edhe në seancat e jashtëzakonshme që i ka ftua opozita, nuk ka ardhur. Ne nuk kemi pas nevojë ta dëgjojmë drejtorin e Arsimit, as drejtorin Oreshka. Por kemi kërkuar seancë të jashtëzakonshme, ku pikërisht ka të bëjë me kryetarin e komunës. Dhe përsëri tash nuk është në sallë. Është fol shumë për këtë transparencën e këtyre pushtetarëve të rinj. Por vërtetë këta nëse e kanë kuptua transparencën është vetëm një facebook, tri fjalë dhe një fotografi. Aq më keq ku Komuna nuk as zëdhënës të komunës, e lëre më të flasin për transparencë. Pyetje për drejtorin e Arsimit. Dëgjova që drejtorët janë emërua po lista nuk është, nuk di ndoshta i keni nëpër zarfe ende, sepse i keni bërë me zarfe ata drejtorë. Pyetje për drejtorin e Administratës. Keqpërdorimi i veturave zyrtare është enormë. Janë heq edhe logot nga veturat të cilat kanë qenë logoja e Prizrenit në veturat zyrtare. Vozitën nga zyrtarët të cilët janë të punësuar me kontrata mbi shërbime të veçanta, të cilët nuk kanë të drejt. Dhe nga drejtorët politik vozitën veturat, që është e ndaluar ajo çështje. Pyetje për komisionin e aksionarëve. A ka më skandal që një komision i themeluar nga ky Kuvend, emëron një të afërm të drejtorit të këtij ekzekutivi, për anëtarë të bordit të Ekoregjionit. Singërisht kolegë të nderuar unë nuk ia kam dhënë votën. Po hiq pishman nuk i bije që nuk ja kam dhënë votën. Sepse të gjitha veprimet që i keni bërë janë skandaloze. Kërkoi nga kryesuesi të ketë kujdes, sepse përgjegjës për të gjitha komisionet e themeluara nga Kuvendi, je ti dhe zyra jote. Andaj kujdes ku po e vulos vulën nëpër komisione, sepse barra bije mbi ty. Drejtor Islami e mora një përgjigje, por nuk qëndron ajo dhjet për qind e orarit, por që të dy ata zyrtarë i ke 24 orë në inspektorat nga radha e kaluar. Ndërsa ky i akuzuari i kulturës nuk e ka dhënë asnjë përgjigje, me të cilën këta kanë ardhur në pushtet me duar të pastra që e kam bo edhe për zambakun edhe për të gjitha këto. Dhe ju pushtetarë, ju klani i djathtë, ju keni thënë atë ditë nuk ka arsye të mbahet seancë e jashtëzakonshme për Zambakun. Sepse kryetari ka paralajmërua që po mbahet. Andaj, a po më tregoni singërisht kur po mbahet zambaku.

Haziz Hodaj (LDK): Edhe unë do doja që të jetë kryetari i komunës prezent, sepse të gjitha pyetjet që i drejtohen, sigurisht që i drejtohen në radhë të parë kryetarit të komunës. Pastaj drejtorët janë këshilltarë të tij dhe secili e merr obligim që të jap përgjigje për dikasteret e vetë dhe dikaster të caktuar. Jam këtu

në radhë të parë për ta paraqit një shqetësim. Sigurisht edhe në regjionet tjera, po në regjionin e Hasit kohet e fundit është shumë e potencuar hajnia. Dhe nuk e di a është takuar ndonjëherë Komisioni për Siguri në Bashkësi. Por unë do ta thërras kryetarin, që ta thërras këtë komision dhe të na informoj se çka është duke u punuar rreth çështjes së sigurisë të qytetarëve. Sepse përveç hajnisë dhe përveç vjedhjeve që po bëjnë, ata po i tmerrojnë banorët dhe familjet, duke hyrë në familje nëpër dhoma. Cili është veprimi i kryetarit të komunës në këtë drejtim, me këtë komision, me njerëzit kompetent. Sepse ne kemi informacione, që edhe po që se i zënë policia, ata pas dy- tri dite janë të lirë dhe prapë e kanë lirinë e operimit për të vjedh. Ne kemi obligim si shoqëri, si pushtet, si anëtarë të Kuvendit, që të merremi me këto shqetësime dhe ti alarmojmë sado që është e mundur ma shumë. Mirëpo organet kompetente duhet të merren me punë konkrete. Ose përndryshe nëse kemi ndonjë përgjigje negative prej organeve kompetente, atëherë duhet t'u lejohet komuniteteve që të organizohet vetë. Se kam dëgjuar nëpër fshatra të Kosovës, që qytetarët janë vetë organizua për mbrojtje, për roje etj. etj. Mirëpo unë besoj që në Kosovë funksionojnë organet e rendit dhe organet e drejtësisë. Nuk do duhej që qytetari ti lihet kjo barrë, sepse kjo barrë është shumë e rëndë, barrë e rrezikshme. E ftoj kryetarin edhe njëherë që sa më shpejtë që është e mundur ta ftoj komisionin, anëtarët e Kuvendit, prej regjioneve të caktuara, që të bisedojmë dhe të shohim se çka mund të veprojmë në këtë drejtim. Unë nuk dua të bëjë pyetje, mirëpo dua të bëjë një vështrim për çështjen e drejtorëve të shkollave. Përkundër asaj që ne kemi dhënë vërejtje të vazhdueshme edhe sistematike rreth emërimit të tyre nuk është ndërmarr asgjë. Unë nuk po dua mu bo demagog këtu. Dhe secili që flet prej jush ose thotë që është depolitizua, ose duhet të depolitizohet arsimiti, bënë veç demagogji, se asnjë send konkret s'mund e bënë. Mirëpo do duhej që tek e fundit me qenë shumë transparent. Njerëzit që i kanë ofrua edhe partitë politike edhe partnerët e koalicionit, njerëzit kompetent, njerëzit profesionist që janë ofrua do duhej të merren parasysh. Fatkeqësisht nuk janë marrë, edhe këtu një parti i ka vendos drejtorët e shkollave. Andaj e kam një sugjerim këtë për kryetarin e komunës, jo për drejtorin e Arsimit. Këta drejtor që janë të përzgjedhur dhe e kanë marrë dje mandatin, të shpallen pronarë të shkollave. Pronarë, definitivisht pronarë. Edhe nxënësit e këtyre pronarëve ta venë nga një shami të kuqe si pionieret e Titos, edhe të shkruhet në shamia pionieret e Nismës. Unë nuk di ndryshe se si mi dhënë kahe ose definicion zgjedhjes të këtij emërimi ose kësaj forme të përzgjedhjes së drejtorëve.

Alush Shala (PDK): Parashtrori pyetje për kryetarin e komunës. Në shkollën ‘Jeronim Susuri’, në shkollën e mesme ‘Gjon Buzuku’, kryetari ka nënshkruar një vendim me datë 19 për emërimin e drejtorëve. Deri me 21 kanë

pas të drejtë ankese, vendimi i ka shkua me datë 19. Andaj nuk e di nëse është respektuar ligji. Nëse po, kërkoi falje. Nëse nuk është respektua kërkoi sqarime.

Po ashtu edhe drejtorit të Arsimit dua t'ia bëjë disa pyetje. Nëse jam gabim, dua ti kërkoi falje, po nëse jo kisha dashtë me na sqarua pse ndodhin këto. Një mësimdhënëse e cila është ankuar dhe ju ka miratua ankesa me datë 22 tetor, në shkollën e mesme "Gjon Buzuk". Dhe komisioni për ankesa, ka marr vendimin që të anulohet lista e kandidatëve të propozuar për drejtor, nga komisioni për ankesa dhe parashtrësia. Por edhe pse drejtorja ka pranuar vendimin për anulim, nuk ka zbatuar, sipas informatave që kam unë. Ju kisha lutur që të na sqaroni lidhur me këtë çështje. Po ashtu nuk e di i nderuari drejtor, që ju keni emëruar dy drejtor, një në shkollën "Abdyl Frashri". Nuk e di a keni vendim që është ndarë ajo shkollë, apo ju keni zgjedh drejtorët e pastaj të ndahen shkollat. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në "Lek Dukagjin". Kisha dashtë me na tregua. I nderuari drejtor i Arsimit, dua ta di se çfarë është bërë me ndërtimin e shkollës dhe a është caktua lokacioni. Gjithmonë bëhet fjalë për shkollën e cila duhet të ndërtohet në lagjen "11 Marsi" dhe që do të shërben edhe për "2 Korriku". Drejtorit të Inspektoratit ju kisha lutur, kur do të merr vendim që ta pastroj vendin të ish "Benafi". Sepse vërtetë është bërë një katrahurë aty, një varrezë e makinave dhe një shëmti për qytetin e Prizrenit. Do të falënderoj nëse ju i keni largua aty dy makina që kanë qenë në hyrje të Prizrenit, që bartin kufoma. Kurse drejtorin e Shërbimeve Publike pyeti kur do të lëshohet uji në "11 Mars", "2 Korrik" dhe në "Dardani". Realisht na keni thënë që duhet të ndodh kjo në fund të shtatorit, mirëpo kjo nuk ka ndodh. E mora një përgjigje nga drejtori i Bujqësisë, ku fare nuk jam i kënaqur. Se deri në qershor veç paskan pas ata qentë liri me ec pa asnjë problem. Po edhe tani i nderuari drejtor ka rrezik, jo ndoshta për neve të rriturit, po për fëmijët të cilët udhëtojnë për në shkollë. Nëse del në Shatërvan po edhe në Bazhdarhane, brenda një ore ke mi pa mbi 30 qenë duke shëtitur aty. Unë e di që janë do procedura që duhet mi ndjek deri në fund, ku edhe unë jam për mi ndjek, mirëpo kur është diçka emergjente, besoj që ju dhe kryetari i keni kompetencat për ta eliminuar këtë problem.

Kastriot Krasniqi: Ngriti një çështje lidhur me rrugën e fshatit Leskovec, ku në 2016 ajo është pastruar njëherë. Aty është mirë që drejtori i Shërbimeve Publike të merre masa, sepse në atë rrugë është investuar diku rreth 600.000 € Aty ka filluar të mbushet me bagremë dhe lloje të ndryshme. Është mirë që drejtori i Shërbimeve Publike të merr masa ndaj asaj rruge dhe të shkoj ta pastroj.

Bardhi Avdaj (PDK): Në seancën e fundit të jashtëzakonshme të thirrur nga partia më e fortë në Prizren, që u diskutua për çështjen e Arsimit, unë nuk reagova. Nga se në fjalimin e fundit, që tha z. Susuri me tha që z. Avdaj nuk e kam personale me juve. Unë sot e mora fjalën për disa arsye. E para dua të ju them qytetarëve të Prizrenit, se unë jam asamblist i juaji dhe jam më votat tuaja. Dhe kjo më bënë mua të punoj pa u ndalur në asnjë moment, për t'ju përfaqësuar juve, e asnjëherë për interesat e mija personale. E dyta, në seancën e fundit, me inicim dhe me urdhër të një analfabeti, u përmenden emrat e disa drejtorëve. Që nuk kursyen asnjëherë vetveten për ti shërbyer arsimit dhe rritjes së nivelit akademik. Ku në atë fjalim për arsye të caktuara, u përmend edhe emri i familjarit tim. E treta, arsyeja pse sot do të flas është sepse këta emra u përmenden nga një person me nivel shumë të ulët njerëzor dhe aspak intelektual. Një prej metodave të ekzaminimit është inspekcioni. Me këtë metodë mund të zbulohen të dhënat e rëndësishme për diagnozën e të sëmurit, nga personaliteti shëndetësor. Pa pasur kontakt fizik, dhe vetëm me të shikuar. Unë si punëtor shëndetësor gjithçka që kam vërejtur tek personi që i shërben klanit të paditurve dhe me aftësi të kufizuara. Ishin fjalim me ndikimin e frikës dhe panikut, që ka kapluar këtë koalicion të panatyrshëm njerëzor. Sjellje artistike dhe bllokim në të folur, që tregon gjendjen kaotike të sëmundjes të skizofrenisë Pranverim Berisha. Ky nocion i përdorur për herë të parë nga psikiatri zviceran Eugen Bleuler, që do thotë shpirt i ndarë, me kënd e ke ndarë shpirtin Pranverim Berisha. Për përmirësimin e kësaj gjendje nevojitet kohë e gjatë. Dhe ka rëndësi shumë të madhe, se secili mjek i bënë vizitat. Prandaj unë edhe njëherë dua ta përsërisë se jam në shërbim të qytetarëve të Prizrenit. Dhe me shumë vullnet do të angazhohem deri në përmirësimin e gjendjes tënde, asamblist i nderuar. Sepse je pjesë e kësaj shoqërie dhe më dhimbsesh shumë, se je në stad të kësaj sëmundjeje. I nderuar dhe shumë i respektuar Pranverim Berisha, ky nuk është problem i vetëm që ke. Problemi juaj dhe që më shqetëson mua më shumë është, përkundër moshës dhe viteve që ke, ti nuk dinë me i lidhë dy fjalë. Pasi që nuk është kryetari këtu, e ftoj nënkryetarin z. Memaj, kryesuesin shumë të respektuar, kolegët dhe mediat, që këtij analfabetit, sot ia kam pru një dhuratë simbolike. Që të kemi sa më pak analfabetë këtu në asamble. Kjo dhuratë është për ty z. Pranverim, një abetare, një libër pune. Edhe po të propozoj në fund, mos e merr mësuesin tënd mësues, se ai është në nivel zero, më nivel zero se ti. Kryesues ndoshta ia jep këtë libër se...

Kryesuesi: Më mirë është me bo dhurata libra, njëri- tjetrit, se sa fjalë. Uroj që kjo traditë të vazhdon në kuvendë. Edhe unë kisha dashtë me ua pru nga një libër kështu. Por ndoshta herën tjetër. Të Sterio Spases, roman Pse. Por po e lëmë për seancën tjetër.

Dafina Billaca (PDK): Unë sot kam zgjedhur të diskutoj rreth fushës, apo stadiumit ish “Koritnikut” në Arbanë. Ku dua të ju njoftoj që fusha e stadiumit e Arbanës ka qenë pronë e ish Progresit dhe në vitin 1975, i është dhënë fshatit Dushanovë. Tani lagja Arbanë, për shfrytëzim të ekipit “Koritniku”. Ku pas lufte është ndërruar emri në klubin futbollistikë “Arbana”. Unë në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar të hy si pikë e rendit të ditës kjo çështje. Shqyrtim dhe diskutim rreth mundësisë së shpalljes së kësaj fushe, apo stadiumi si pronë me interes publik. Në këtë takim u pajtuam që të fillojnë procedurat administrative për pronën në fjalë. Andaj i bëj thirrje kryetarit të komunës si dhe drejtorisë, apo sektorëve përkatës, të cilët ndërlidhën me këtë çështje. Të marrin veprime konkrete si, identifikimin, matjen dhe skicimin e kësaj parcele, e cila është me numrin 561/3 me një sipërfaqe prej 13904 metra katrorë. Në zonën kadastrale Dushanovë, më emër të P.Sh.K “Progres”. Kërkoj që kjo pronë të kthehet nën menaxhimin e Kuvendit komunal, më qëllim që të mund të shfrytëzohet nga qytetarët e lagjes dhe Prizrenit gjithashtu. Në të njëjtën kohë të hapët rruga për investime dhe të kthehet një nga stadiumet që ti plotësonte kërkesat dhe nevojat e adhuruesve të sportit. Pra, aprovimi i kësaj kërkesë do të ndikonte pozitivisht në interesat e qytetarëve. Pasi një lagje me rreth 20.000 banorë nuk ka asnjë hapësirë tjetër për aktivitete sportive. Andaj pres një mirëkuptim nga ana e juaj kryesues, që në seancën e ardhshme të hy si pikë e rendit të ditës edhe kjo çështje. Dhe të raportohet nga drejtoritë përkatëse rreth dokumentacionit të kësaj parcele. Ndërsa një temë krejtësisht tjetër është edhe vendosja e tabelave informuese në lidhje me monumentet e qytetit. Ku më të vërtetë aty janë vërejtur gabime të mëdha drejtshkrimore, dhe në përkthimin adekuat në gjuhën angleze. Sinqerisht është për tu ardhur keq, si ka mundësi të bëhen gabime aq të thjeshta. Ku edhe një nxënës i klasës së tretë do ta shkruante fjalën center, që në shqip i bie qendër. Do ta shkruante drejtë, e jo siç është shkruar centar, sepse kjo fare nuk është në gjuhën angleze. Gjithashtu edhe përkthimi për Lidhjen e Prizrenit është përkthyer gabimisht. Ku nuk përputhet fare me Lidhjen e Prizrenit. Andaj kërkoj nga drejtoria përkatëse të ketë kujdes në këto çështje. Të angazhohen njerëz profesionist të gjuhës angleze dhe të gjuhëve të tjera zyrtare. Dhe nëse nuk e kenë një kuadër të tillë. Jam e gatshme të kontribuoj në këtë çështje, në cilësinë e profesoreshës të gjuhës angleze. Kërkoj që këto tabela njoftuese të korrigjohen menjëherë. Dhe të mos japin mesazh të mosdijes dhe të një qeverie analfabetesh, tek qytetarët dhe tek vizitorët e huaj, që do ta vizitonin Prizrenin.

Kryesuesi: Në mbledhjen e KPF-së, u bë propozimi në lidhje me nisjen e procedurës për shpalljen e interesit publik për ish stadiumin e “Koritnikut”.

Dhe se ndoshta është raportua gabimisht në media. Është thënë se sot do të vendoset për këtë çështje, jo. Vetëm është dërguar rekomandim Drejtorisë së Kulturës, e cila më njoftoj se ishte në procedurë, për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm. Brenda një kohe të arsyeshme presim që të finalizohet kjo procedurë dhe të na vij propozim-vendimi i nënshkruar nga ana e kryetarit, në Kuvend.

Behar Begaj (LDK): Unë kisha një pyetje t'ia bëjë direkt kryetarit. Por edhe pse s'është këtu më siguri që edhe kryetari do ta merr këtë mesazh. Është një mesazh që ndoshta i kishte takua kjo pyetje drejtorisë të Arsimit. Por unë desha direkt ti drejtohem kryetarit. I nderuar kryetar, unë nuk e di se sa jeni të njoftuar se gjatë përzgjedhjes së drejtorit që është bërë, në atë komision, më sa e di unë duhet të merr pjesë edhe një anëtar nga Këshilli drejtues i shkollës. Në shkollën tonë për fat të keq, e dinë edhe drejtori se nuk ka këshillë drejtues. Përderisa në atë këshillë drejtues kam qenë pjesë e këshillit edhe unë. Dhe këshilli drejtues ka pushuar aktivitetin dhe nuk është bërë një zgjedhje e re nga ai këshill. Mendoj se këtu është bërë një shkelje, një lëshim i qëllimshëm, sepse edhe kandidati e dinë se në shkollën tonë nuk ka këshillë drejtues. Krejt pra që dua të cekim është se javën e kaluar është thyer shkolla në Zhur dhe organet e rendit nuk janë të njoftuar për këtë. Desha ta pyes kryetarin, se a është kryetari i njoftuar për këtë çështje apo jo? Kryetar e treta që dua të cekim prapë, është rreth sallës sportive në shkollë, e cila sallë ka kaluar tri vite që kanë filluar punimet dhe ende është e papërfunduar. Dita ditës ajo shkatërrohet dhe askush nuk mbanë përgjegjësi për të. Ndoshta do ta ketë fatin e njëjtë si të shtëpisë së Kulturës. Shpresoj kryetar që këto ti merrni parasysh dhe të intervenoni sa më shpejt që është e mundur, që të zgjidhen këto probleme dhe të ndërpriten këto marifete që po ndodhin rreth përzgjedhjes së drejtorëve, në mënyrë të paligjshme.

Vjollca Kabashi (AAK): Pyetja ime ishte për drejtorin e Shërbimeve Publike. Desha të paraqes prapë kërkesën e rrugës së lagjes së Duhit, ku nuk mora asnjë përgjigje nga kjo kërkesë, që dy seanca që i paraqes. Ku kjo rrugë e lagjes së Duhit me gjatësi 480 metra, e gjerë me 5 metra, e ndërtuar me mjete të qytetarëve para luftës, është e dëmtuar për shkak të punimeve nëntokësore, të cilat në atë kohë kanë qenë të papunuara. Pas luftës në atë rrugë është punuar sistemi i ujësjellësit, kanalizimit dhe rruga është dëmtuar shumë. Po për këtë rrugë është bërë kërkesa në komunë edhe nga banorët e lagjes. Po ashtu kërkoi të rregullohet transporti në fshatin Korishë. Ku transporti është tri herë në ditë. Ku banorët duhet të ecin në këmbë 1.5 km. Ju kisha lutë që të rregullohet linja për banorët. Në bashkëpunim me firmën që udhëheqë këtë linjë dhe linjën

lokale. Ku paga për nxënës të jetë 30 cent. Ndërsa nxënësit nga komuna e Therandës, udhëtojnë me 50 cent Therandë-Prizren.

Shukri Quni (PDK): Unë i kam bërë disa pyetje, për drejtorin e Shërbimeve Publike, mirëpo përgjigje nuk kamë marrë. Është kërkesë për trotuar në fshatin Nashec. Kjo kërkesë është bërë edhe më herët nga ish kuvendarët e LVV-je. Kërkoj që të ndërtohet trotuari, sepse rrezikohen fëmijët për në shkollë. Po ashtu kam bërë edhe një kërkesë për rregullimin e rrugës Planej-Trumsh. Edhe Artani ka qenë i njoftuar po tash nuk është këtu. Ka premtuar që do ta rregullojnë, së paku për 14 dhjetorin, ditë e rënies së dëshmorëve në Pashtrik. Për drejtorin e Bujqësisë kam bërë një pyetje, po përgjigja shumë e thjeshtë mu duk. Në fakt përgjigje nuk ka, po thotë ju njoftoj se lista e përfituesve është në ueb. faqen e komunës. Unë kam kërkuar disa kriteret të cilat i përfitojnë fermerët, lopët qumështore. Unë nuk jam i kënaqur drejtor me këtë përgjigje. Sepse s'po e di tash, nëse një fermer i ka 30 lopë, ja keni dhënë ju edhe një, janë bërë 31. Apo ndonjë fermer i ka 4 lopë, ja keni edhe një, i ka bërë 5. Ose s'ka hiq për shembull dhe ja ka dhënë komuna. Edhe sa munden me përfituar aty, një fermerë apo një anëtar i familjes, a dy a tre. Do më thënë janë disa kriteret. Se më herët është kritikuar qeveria se kanë marrë njerëzit, kjo në media ka qenë. Që s'ka fare as fermë, po ka marrë lopë. Ose ka edhe zëra tjerë p.sh., që materiali ndërtimor është marrë edhe është shit. Unë kërkoj që me emra të cilët e kanë bërë me qit, me thënë ky person e ka bo këtë. Ose ky person e ka bo këtë. Keni bo disa investime në Nashec, keni hap do bunarë aty, për të cilën punë ju përgëzoi, sepse është punë e mirë. Mirëpo aty ku nuk është mirë unë ka me kritikua. Unë kam kërkuar që mu shpërndarë sistemi i ujitjes në atë pjesë. Ajo tokë dikur është ujit. Në atë tokë ku ke shkel atë ditë që e ke hap bunarin, ajo është ujit, me ujë të Lumëbardhit të Prizrenit. Aty duhet edhe një investim i vogël, se aty uji shkon prej Lumëbardhit të Prizrenit. Ajo fushë që është ujit ka rreth 60-70 hektar që janë. Po tash nuk funksionon. Plus e kam bo kërkesën që të riparohet. Në fakt e kam kërkuar edhe kur është aprovua buxheti, të riparohet sistemi i ujitjes për në Nashec, Grazhdanik edhe Hatmaxhë. S'ka nevojë as verës me përdor dikush ujin e pijes, kur ne e kemi ujin e vaden, ashtu ne i themi. Ka funksionuar ajo, po tash ka nevojë për riparim. Se i kemi ndërtuar vetë ato farë shakte që i themi ne. Kështu që këtë përgjigje që ma keni dhënë nuk mu duk pale sa... Artanit pata mi dhënë një vërejtje që nuk është mirë, kur kalohen këta kolegë kuvendarë në personale. Sepse ndoshta dikush kënaqët edhe e mbush me lloj, lloj komente, me çfarë njerëz janë duke na udhëheqë në asamble. Po këtu janë do pak edhe më të vjetër që janë. Që ne duhet mi dhen edhe disa kritika, se ky Kuvend, nuk është këtu për personale shumë. Se nuk na kanë pru këtu as anëtarët e familjes, po as një rreth apo një

mëhallë. Po na ka pru një elektorat i gjerë. E kështu kolegë kuvendarë, atij djalit ju përmend emri. S'ka nevojë me reagu as ai tash. Po them kështu si më i vjetër. Po edhe ky që ia ndërpreva fjalën, e nuk e ndërpret. U deshtë me ia ndërpre Artani. Me këto ta quaj 'cirk' në Kuvend, nuk është mirë. Kemi me dal ne ndonjëherë prej temës, por jo në këtë ekstrem. Se nuk e di qysh do të vjen pastaj fundi. Se kur të fillojmë me këso farë akuza, e këto kritika, po ju tregoj që po e shoh si një fund jo të mirë. Se kur t'ia jep dikujt, ka me dal edhe ai ty me tu kundërvu. E ti lëmë këto gjëra, por të shkojmë në ato që na ka pru këtu qytetari. Edhe ti shprehim brengat e qytetarëve. Se këtu është më shumë personale se sa është që jemi ardhur për qytetarët. Këto desha Artanit me i thënë, po nuk është.

Memnuna Ajdini (Vakat): Ja u se obratiti u ime meštana sela Pouska. Najpre predat je zahtev, pitanje se odnosi na direktorijate ve i broj. Dakle radi se o Direktorijatu za Kadastar, za Urbanizam, za Poljoprivredu, Komisiji za Imovinu. A pitanje se odnosi na imanje koje se nalazi u ataru sela Pousko. Gde je izgra en restaorant Panorama. Te je uzurpiran i postoje i put meštana. Koje ina e su koristili za parcele. A nalazi se u njegovoj blizini. Dakle meštani ne mogu da idu na svoje parcele, da obra uju njegove parcele. Upravo iz razloga što vlasnik Panorama zabranjuje. Tražim da direktor Kadastra pošalje jednu svoju ekipu, i da izvrše merenje. I pri tome postoje i put oslobode u koiš enju meštana. Drugi zahteve se odnosi za direktora za Javne Usluge. A ti e se meštana sela Re ane. Dakle radi se jedan ve odbrambeni zid u Re nu koritu Bistrice. Taj odbrambeni zid je svakako dobro došo. Me utim moramo znati da odbrambeni zidovi moraju i i uskla eno i sa jedne i sa druge strane. I upravo jedna deonica je jako ugrožena. Pa zahtev meštana Re ana se odnosi i da sa druge strane se odradi jedna mala deonica odbrmbenog zida. ime bi re no korito imalo bi pravi tok. Tako e o ekujem da se pitanje svih direktora, ali pre svega ja se obra am za školu „Meto Bajraktari“ rešu što pre. I tako e bi zahtevala od administracije da prospekt koji je dat samo na albanskom jeziku, o budžetu opštine Prizren. Bude i na ostale jezike manjina.

Cenet Sajadi (KDTP): Te ekkürler Ba kan. Kosova Diller Yasası, Topluluklar Hak ve Çıkarlarını Koruma Yasası ile Prizren Belediyesi Diller Yönetmeli ine göre Türkçe e it statüde resmi bir dildir, Sırpça ve Arnavutça'yla. Yasa 2.3.maddede bunu öyle açıklamaktadır: “Ana dili resmi dil olmayan bir toplulu un o belediyedeki genel nüfusun en az % 5'ini olu turması durumunda bu topluluk dili o belediye içerisinde resmi dil statüsüne sahip olur ve resmi dillerde e it haklı olarak kullanılır. stisnai olarak Prizren Belediyesinde Türkçe dili resmi dil statüsüne sahiptir.” Dolayısıyla Yasaya ba lı olarak

Belediyede Türklere talep do rultusunda: ekstrakt, do um belgesi, evlilik belgesi vs. verilmemeli, tüm ahsi evraklar belediyemizde tek model olmalıdır. Yasa gere i talep do rultusunda de il, bütün evraklar: Arnavutça, Sırpça ve Türkçe olmalıdır. Bir di er konu da Prizren Belediyesinde iki mühür kullanılmaktadır, ki bu Kosova Anayasası, Dillerin Kullanımı Yasası, Topluluklar Hak ve Çıkarları Koruma Yasası ile Prizren Belediyesi Diller Yönetmeli ine aykırıdır. Halbuki Belediyemizde tüm evraklar Türk dilinin de oldu u tek model mühür kullanımı gerekmektedir. Bir di er soru da Kurula semtinde yapılacak olan kanalizasyon projesi ne zaman ba layacak ve tamamlanma süresi ne zamandır? Bir di er soru: Bajdarhane çar ısında uzun zamandır kaldırım ve ıklandırma sorunu bulunmaktadır, bu konu ne zaman bir sonuca ula acaktır?

Cennet Sayhadi: Faleminderit Kryesues. Në bazë të Ligjit për Gjuhët, Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe në bazë të Rregullores për Gjuhë të Komunës së Prizrenit, gjuha turke është një gjuhë me statut të barabartë me gjuhën serbe dhe shqipe. Në bazë të nenit 2.3 të ligjit kjo theksohet në këtë mënyrë: “Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën s paku 5% të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do t ketë statusin e gjuhës zyrtare në at komunë dhe do përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësisht kësaj q u tha m lartë, n mënyrë t veçantë, n komunën e Prizrenit gjuha Turke do t ketë statusin e gjuhës zyrtare.” Prandaj duke u bazuar në ligj, ekstrakti, certifikata e lindjes, certifikata e kurorëzimit etj. nuk duhet të jepen në bazë të kërkesës së turqve, të gjitha dokumentet personale duhet të jenë një model. Në bazë të ligjit të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, serbe dhe turke e jo në bazë të kërkesës. Një çështje tjetër është se në Komunën e Prizrenit përdoren dy vula dhe kjo është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për përdorimin e gjuhëve, ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve si dhe me rregulloren për gjuhët të Komunës së Prizrenit. Megjithatë, në të gjitha dokumentet në komunën tonë duhet të përdoret një vulë e vetme e cila është edhe në gjuhën turke. Një pyetje tjetër është projekti i kanalizimit që do të bëhet në lagjen Kurilla, kur do të fillojë dhe sa do të jetë kohëzgjatja e saj? Një pyetje tjetër: Në çarshinë e Bazhdarhanes ekziston problemi i trotuarit dhe ndriçimit, kur do të gjejë një zgjidhje kjo çështje?

Samra Iljazi (NDS): U ime NDS želim da pozvalim direkotra Javne Službe, g. Leventa Kasemi. Za kocke koje su postasvljene u Kurilo. Mi smo

tražili nekoliko godina inesticije u Kurilu, bosebno gde žive bošnjaci. Ali tad nismo naišli razumevanja. Tražim od vas direktore da zajedno samnom iza ete na teren gde ima potrebe još za dve male ulice. Jer dolazi zima i uslovi su jako teški za sve naše građane koje žive tu.

Cengiz Česko (KDTP): Te ekkür ederim sayın Başkanım. Hepinizi saygıyla, sevgiyle selamlıyorum. Benim sorum Ehat Oreshka beye olacak, kendisi u anda burda yok çıkmı ama Cemal Beri a Kültür Eviyle ilgili bir soru sormak istedim. Özellikle son, (Kusura bakmayın görmedim), özellikle son sene bizim Türk derneklerimiz orada maalesef faaliyet yapamamaktadır, yani ne zaman bir dilekçede bulunsalar orada herhangi bir faaliyet yapamıyorlar, sürekli salonların meşgul oldu unu yani dolu oldu unu söylüyorlar, bu konuda yani bu kültür evinin statüsü nedir, neden böyle bir durumdan ibaret oldu unu bize bir açıklama yapabilir misin, çünkü sadece Türk dernekleri de il Prizren'de di er multi etnik dernekler de Arnavut dernekleri de bu durumdan çok müzdarıpları, bununla ilgili bir çalı manın bir adımın atılması gerekti ini dü ünüyorum. Di er sorum sayın Eğitim Müdürümüz Skender Susuri'ye, mutlaka bu konuda haberleri vardır, son günlerde okullarımızda gençlerimiz sık-sık esrar kullanımı ile polis tarafından yakalanılmaktadır ve bunun en aza-minimuma indirilmesi için Eğitim Müdürlü ümüzün bu konuda herhangi bir adımın atılması gerekti ini dü ünüyorum ve buna yönelik bir plan ve stratejinin olması gerekti ini dü ünüyorum çünkü her geçen gün gençlerimiz sürekli esrar kullanımının arttı nı görmekteyiz. Prizren'de polisimizin özellikle sivil polislerin yapmı oldu u operasyon sonucunda bunların yakalandı nı ancak bu durumun hala devam etti ini görmekteyim. Di er bir sorum ise Osman Hajdari'ye, Prizren Belediyesinin internet sitesinde Türkçe dilinde herhangi bir raporların yayınlanmadı nı görüyorum, müdürlere ait çalı ma raporlarının, bu konuda yani bundan sonra hem Bakanlar da bunu mutlaka dile getirecektir yani onların çalı ma raporlarına ait hem Türkçe dilinde hem Boşnakça Dilinde yayınlanması gerekti ini dü ünüyorum bunlara lütfen dikkat etmeleri gerekti ini söylüyorum. Te ekkür ederim, saygılar.

Cengiz Česko: Faleminderit zotëri kryesues. Ju përshtesë të gjithëve me respekt. Pyetje ime është për zotëri Ehat Oreshka, edhe pse ai nuk është këtu ka dal, kam një pyetje lidhur me shtëpinë e kulturës Xhemali Berisha. Në vitin e fundit shoqatat turke nuk po mund të bëjnë aktivitete aty, pra sa herë që bëjnë kërkesë nuk po mund të bëjnë ndonjë aktivitet, vazhdimisht ju thuhet se salla është e plotë. Lidhur me këtë çështje dëshirojë të dijë statusin shtëpisë së kulturës. A mund të na jepet një sqarim pse qëndron kështu ky fakt, pasi që jo vetëm shoqatat turke por edhe shoqatat tjera multietnike edhe shqiptarët po

ballafaqohen me këtë. Unë mendojë se duhet të bëhet një hap lidhur me këtë çështje. Pyetja tjetër është për drejtorin e Arsimit z. Skender Susuri. Me siguri janë të njoftuar edhe ata, ditëve të fundit nëpër shkollat tona të rinjtë janë duke u zënë nga policia për shkak të përdorimit të drogës. Unë mendojë se drejtoria e arsimit lidhur me këtë çështje duhet të merr ndonjë hap, që të ulet në minimum. Lidhur me këtë duhet të jetë një plan dhe strategji pasi që jemi dëshmitar që çdo ditë më tepër po shtohet numri i përdoruesve të drogës tek të rinjtë. Shohim se ditëve të fundit policia, e sidomos policia civile është duke i zënë këta në Prizren, mirëpo kjo gjendje akoma është duke vazhduar. Pyetja tjetër është për Osman Hajdarin, faqja e internetit e Komunës së Prizrenit, shoh se nuk ka publikuar raportet në gjuhën turke, raportet e punës së drejtorive. Lidhur me këtë çështje me siguri edhe boshnjakët do ta theksojnë pasi që unë mendoj së raportet e punës duhet të publikohen edhe në gjuhën turke edhe bëshnjakeshit. Andaj, ju lutem që të keni më tepër kujdes në këto çështje.

Kujtesa Kabashi Shatri (LDK): Parashtrori pyetje për kryesuesin, se a është paraparë ndonjë shumë për ngritjen e kapaciteteve të kuvendarëve. Nëse është ndarë, çfarë është planifikuar me to. A ka ndonjë plan Kuvendi për këtë?

Kryesuesi: Po, zyra e Kuvendit e ka një shumë. Një pjesë të buxhetit që përbëhet prej dy kategorive. Është paga, mëditje që i merrni ju dhe kategoria tjetër mallra e shërbime. Të cilat si kategori e përgjithshme ku ndahet nëpër drejtori. Mund të parashihen projekte të tilla. Në qoftë se ka ndonjë iniciativë, pse jo. Po kryesisht këto ngjitja e kapaciteteve, deri tash është bërë prej organizatave të ndryshme, shoqëritë civile, prej Ministrisë të Pushtetit lokal. Besoj mbani në mend këto trajnimet në fillim të mandatit që i patëm. Dhe rrjedhimisht si Kuvend, nuk është se kemi pas ndonjë nevojë ekstra krahas me ato që kanë qenë. Ose nëse gjatë kohës na del ndonjë kërkesë, ose diçka e rëndësishme pse jo.

Sherife Balaj (PDK): Unë po shoh në rendin e ditës kemi destinimin e tokës bujqësore për një parcelë. Nuk e di për çka do të shfrytëzohet kjo, edhe pse ne duhet me votua. Duhet me qenë një arsye shumë e fort. Sepse ne e dimë krahurën të cilën ia kemi shkaktuar vetvetes tonë, duke përfshi gjithë territorin e Kosovës, me këto destinime dhe ndërtime të detonizume. Edhe nëse është private nuk ka kurrfarë arsye ne këtë me votua sot në sallë. Duhet me qenë shumë, shumë, shumë e arsyeshme. Ndërsa kam bo dy takime me drejtorin Kulturës, për destinimin e një parcele të tokës së Pylltarisë, për stadiumin e

Gjonajve, për të cilën Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ka ndarë mjete financiare për një stadium të tillë. Apo një fushë e futbollit, sepse ndoshta nuk është një stadium, i cili mundet me qenë shumë i madh. Mirëpo, është një fushë e futbollit dhe ende nuk ka bo kurrë Drejtoria e Kulturës tash e disa muaj. Është emergjente besoj për shkak të ndarjes së buxhetit prej Ministrisë së Kulturës. Dhe ato mjete munden me shkua në suficit. Nuk është diçka mirë! Ndërsa ne sot kemi në rend të ditës një pikë e cila nuk e dimë as vetë për çka do të shfrytëzohet edhe pse do të destinohet. Për shenjëzimin e tabelave orientuese nga Drejtoria e Turizmit, u diskutua, ka qenë një lëshim apo diçka e cila është një pasqyrë shumë e keqe. Duhet mu përmirësua. Ndërsa për mirëmbajtja e ueb faqes po në këtë drejtori, është bërë një kontratë me një kompani, për mirëmbajtjen e një ueb faqe në rrjet elektronik, me 23.000 € 23.000 €, mi nda për mirëmbajtje të një ueb faqe të një drejtori. Kur e kemi një ueb faqe të përgjithshme të komunës. Dhe me një shumë aq marramendëse, unë nuk po mundem me kuptua. Ndërsa vitet e kaluar ka qenë po ashtu një kontratë, më sa e di unë 500 ose 600 € për mirëmbajtje. Ndërsa tash kemi 23.000 € Në rregull, na arsyetoni pse? Kur folëm për rrezikun e qenve endacak, ky problem është i shprehur edhe në fshatra. Jo vetëm në qytet, mos të fokusohuni vetëm në qytet. Sepse ka banorë Prizreni edhe jashtë Shatërvanit. Dhe po ju tregoj një storje para disa dite që më ndodhi personalisht, në fshatin Piranë. U detyrova me ndal makinën për mi ndihmua një vajze 5-6 vjeçare, e cila ishte e rrethuar prej 5-6 qenve. Edhe kjo duhet mu marrë më seriozisht, nëse nuk është bërë deri tash. Le të mendohet prej tash se çka me bo me këtë rrezik, sepse fëmijët tonë po rrezikohen. Dhe të mendohet që sot prej drejtorit të Bujqësisë, apo kujt do qoftë prej komunës, për një shtëpi strehuese për qentë endacak. E di që në Kosovës, mos gabofsha në Suharekë është një shtëpi e tillë. Mirëpo për shkak të shpenzimeve të mëdha, nuk mundet me ekzistua. Mirëpo komuna e Prizrenit është një komunë e madhe dhe të bëjë marrëveshje me komunat tjera, që të mendohet së paku për një fillim të mbar, për një gjë të tillë. Po e ceku prapë në lidhje me rrugën në Has prej 38 km. që u bona bajat duke e përmend që s' di sa seanca. Sipas informacioneve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe ministrit Pal Lekaj, ato mjete të cilat i ka ngrit deputeti Nezir Çoçaj, tash e dy vite për destinim të mjeteve për rregullim të rrugës në vitin 2017-2018, si kod ekonomik, më sa e di unë ka arrit shifra 350.000 € Mirëpo asnjë hap nuk është bo për me iniciua një projekt në tenderim. Sipas ministrit thotë, që këtë javë do ta qesim në tenderim. Mirëpo, ajo çka më shqetëson mua të zot e kësaj shtëpie, nuk i intereson askujt në komunën e Prizrenit. Drejtorit të Shërbimeve Publike, kur unë i bëjë pyetje më thotë nuk e di. Qysh nuk e dinë! A është aq vështirë me marrë telefonin, kur e ke pa pagës prej zyrës, ose me ato mbushjet prej 30 € që ti qet komuna. Po thirre, nëse përton me shkua në Prishtinë. Së paku interesohu.

Sepse hasjanët janë shumë të shqetësuar. Edhe vet detyrohem me shkua me kilometra më larg, me shkua deri në shpi, për shkak të gjendjes së tmerrshme të rrugës. Ndërsa për raportin e materialit ndërtimor prej tri drejtorive. Materialin ndërtimor për ndërtimin e shtëpive dhe renovimin e shtëpive. Tash e disa vite traditë kjo e komunës së Prizrenit që se ka pas deri më tash asnjë komunë tjetër, dhe është shembull. Unë shumë herë kam kërkuar raport, mirëpo nuk kemi. Aq tragjike është me raportua për një gjë të tillë a! Gjysmë milioni është në pyetje. Nuk është veç për lista, po le të na tregojnë cilët janë përfituesit dhe duhet me dhënë raport. Kam pyetje prej fshatarëve prej Landovicës. Shqetësohen për ujin e pijes në fshatin Landovicë. Po ashtu rruga për tek varreza në fshatin Landovicë, që thonë është e tmerrshme. Dhe rregullimi i varrezave të martirëve që janë varrezat e martirëve përball varrezave të dëshmorëve. Ka edhe shumë pyetje dhe kërkesa prej qytetarëve. Mirëpo nuk po e zgjati më tepër, se po bëhen zhurma që e kam kalua minutazhin. Po merrni parasysh ato minutazhat e juve që po teprohen.

Kryesuesi: Kjo çështja e minutazhës përnjëmend është pak problematike, për shkak se e kemi një rregullore që e kemi bo në mandatin e kaluar dhe e kufizon në dy minuta. E di që brenda muajit ndodhin shumë ngjarje që anëtarët e Kuvendit donë mi ngritë. Mirëpo, tash dy gjëra këtu janë. Ose duhet me respektua një rregullore që e kemi, ose, e kemi formua komisionin statutar. Po presim përgjigje të MAPL-së lidhur me ligjshmërinë. Edhe po e kthejmë atë dispozitën e vjetër për pesë minuta. Mandej jemi në rregull, e dimë që zgjatë pika, edhe përgatitemi për secilin. Po diçka duhet me bo në këtë drejtim.

Fatmir Kastrati (AAK): Unë desha me shtrua përsëri pyetjen lidhur me ujin e pijes në lagjet: “2 Korriku” dhe “11 Marsi”. Mirëpo, sapo e mora një përgjigje nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Edhe është një përgjigje që ma merr mendja punët veç paskan përfundua. Kanë mbet vetëm Hidroregjioni të lidhet me rrjetin e rrymës dhe kjo punë krehët. Në qoftë se është kështu. Unë e falënderoj drejtorin e Shërbimeve Publike për interesimin. Por e kisha lutur kryetarin e komunës, që ta ushtroj autoritetin e vetë mbi drejtorin e ujësjellësit, në mënyrë që vërtetë kjo punë të kryhet njëherë e përgjithmonë sa është ma mirë. Dhe e dyta kryesues, nuk e di pse mbledhjet po mbahen të premtën. Po më duket edhe zonja Osaj e shtroj më herë, sepse nuk isha këtu. Ne qysh në fillim kemi kërkuar nga punëdhënësit tanë që të na lejojnë që të enjten ti mbajnë takimet këtu në Asamblenë komunale. Edhe nuk ma merr mendja që ka ndonjë arsye të fortë që mbahen të premtën. Andaj ju kisha kërkuar që këto takime të mbahen përsëri të enjten.

Petrit Hoxhaj (LDK): Më të vërtetë është shqetësuese mospjesëmarrja e kryetarit në seancat e Kuvendit komunal. Ku vetë VV-ja ka qenë njëra prej kritikuesve në qeverisjen e kaluar, pse Prof. dr. Ramadan Muja nuk ka marrë pjesë. Ndërsa një gjë e tillë veç është duke ndodhur tash përsëri. Shqetësimi i jonë është, sepse ne dojmë mi ngritë disa pyetje drejtpërdrejtë me kryetarin e komunës, se është zot shtëpie i këtij qyteti. Çështja ka të bëjë me buxhetin e klubit “Bashkimi”, ku është ndarë njëfarë lloj buxheti. Mirëpo, nuk është paraparë buxhet për klubin “Bashkimit” për femra. Pasi që është një kampion i Kosovës ky klub dhe nuk është paraparë të ndahet buxhet. Nuk e di a e dinë kryetari, mirëpo ky klub është i ndarë veç prej klubit “Bashkimi” të meshkujve. Janë dy klube të ndara. Dy klube që kanë anëtarësitë e tyre, bordet e tyre. Mirëpo kishte qenë mirë të parashihet që së paku 30% prej klubit të meshkujve të ndahet për klubin e femrave. Pasi që këta janë kampion. Dhe sipas të gjitha gjasave këta veç janë duke e mbrojt titullin e kampionit edhe këtë vit. Ndërsa tek meshkujt nuk është vërejt një gjë e tillë. Tjetra ka të bëjë me drejtorin e administratës. Çka ka ndodhur me punëtorin që ka pësuar një aksident gjatë orarit të punës, në objektin e komunës. Si është gjendja e tij shëndetësore dhe sa është ndarë buxheti për këtë punëtor. Dhe ku gjendet ai punëtor i komunës? Ndërsa një falënderim shkon për drejtorin e ri Visarin. Që dy muaj që është bërë drejtor, ku ka një rezultat të mirë dhe ka një meritë prej qytetarëve, e sidomos me pajisjet e aparaturave të reja që janë duke i sjellë në aspektin e shëndetësisë.

Kryesuesi: Unë po e jap një përgjigje të shkurtë. Unë e kuptoj opozitën pse e kërkon prezencën e kryetarit. Por pozita, i ka mekanizmat e vetë, i ka drejtoritë, e ka nënkryetarin. Sidomos që është prezent në sallë dhe që është personi i autorizuar që mundet me fol, besoj edhe në emër të kryetarit.

Agnesa Sinanaj (AAK): Unë sot nuk pata ndonjë shqetësim kështu me paraqit, por nuk po mundem pa e thënë këtë. Sa i përket pa dashtë me i dhënë frymë, fjalimit për keqardhje të z. Bardhi. Vetëm desha me thënë, kur ja dhuron dikujt një libër, është e vërtetë që dhurata më e mirë që mundesh me ia dhënë dikujt është libri. Edhe sipas përvojës time, kur ia kam dhuruar dikujt një libër, ose kur mu ka dhuruar mua. Paraprakisht ai libër u lexua nga dhuruesi. Kështu që kur ia dhuron dikujt atë, duhet me lexua vetë paraprakisht. Me ja ditë përmbajtjen tani ja dhuron dikujt tjetër, dhe ia shpjegon atë.

Kryesuesi: Unë e mbajë në mend Abetaren në atë kohë kur ka qenë me figura të partizanëve. Dhe kjo është hera e parë që po e shoh, është libri i parë. Nëse pajtoheni, drejtorët ti kthejnë përgjigjet me shkrim.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i kartës së qytetit të Prizrenit.

Kryesuesi: Theksoi se kemi mbajtur disa takime me iniciuesit e kësaj kërkesë, të cilët vijnë nga organizata, Ec Ma Ndryshe. Fjala është për një dokument të përgjithshëm, që është përmbledhje e drejtë dhe themelore e njeriut. Ku synohet që të vendosen disa parime, kritere për mbrojtjen dhe përfaqësimin e grupeve të nën përfaqësuar. E kemi mbajtur një takim me anëtarët e Komitetit dhe shefat e grupeve për këtë qëllim. Besoj që keni pas rastin të informoheni, nga përfaqësuesit e juaj. Po nëse e shihni të arsyeshme. Ne këtu e kemi edhe hartuesin e këtij dokumenti, i cili mund të bëjë një shpjegim të shkurtër Kuvendit, se për çka është fjala. Po vazhdojmë me qëndrimet e shefave të grupeve.

Simir Krasniqi (PDK): Po shoh që disa nuk janë mirë të informuar. Do të ishte mirë Fisnik që ta bënte një prezantim, rreth kartës së qytetit.

Adem Shabanaj (LVV): Ne e përshëndesim iniciativën e marrë nga Ec Ma Ndryshe. Dhe si grup i LVV-je jemi të qartësuar për këtë iniciativë dhe e mbështesim.

Haziz Hodaj (LDK): Pse shefi i grupit parlamentar i PDK-së po kërkon sqarim, kur ne e kemi pas një takim edhe jemi sqarua. Do më thënë ka qenë Alush Shala përfaqësues i juaj, edhe sigurisht se ju ka njoftua në lidhje me dokumentin. Tash mos me na maltretua, se bëhet fjalë për një dokument shumë atraktiv. Një dokument themeltar i të drejtave të qytetarëve të gjitha kategorive, të gjitha nacionaliteteve etj. etj. Kështu që unë besoj që aprovimi në mënyrë anonime i këtij dokumenti do të ishte mirë. Jo veç për hartuesit por edhe për qytetarët e Prizrenit. Andaj veç kisha kërkuar prej hartuesit, që të jetë këmbëngulës në implementimin e këtij dokumenti dhe në jetësimin e këtij dokumenti. Përndryshe është një dokument që është një atraksion për Prizrenin.

Illir Baldedaj: Pasi ky ekzekutiv s'po punon kurrëgjë, e falënderoj Ec Ma Ndryshe, e cila e ka marrë një iniciativë. Dhe vërtetë që ja vlen me diskutua. Dhe grupi i AAK-së do ta mbështetë këtë iniciativë. Po insha Allah, e zgjon nga gjumi pushtetin.

Ganimete Babuna (Nisma): Edhe Nisma Socialdemokrate e përshëndet organizatën Ec Ma Ndryshe për një temë kaq të mirë të këtij projekti. Urojmë që të zbatohet. Kështu që ne e mbështesim.

Sencar Karamuço (KDTP): Na si parti do të përkrahim.

Edis Aljilji (Vakat): I koalicioni Vakat se slaže sa ovi. Samo bi dao jednu primedbu. Trebalo bi raspored prevoda da bude druaga iji.

Kryesuesi: NDS nuk qenkan. Para se ta hedhim në votim miratimin. Nga ky dokument del po ashtu edhe një obligim, që Kuvendi krahas miratimit të këtij dokumenti të themeloj edhe një komision, i cili ka për detyrë që të përcjellë hapat dhe implementimin e këtij dokumenti. Rrjedhimisht edhe sipas rekomandimit të KPF-së, që u diskutua. Po veçanërisht edhe me vetë idenë e propozuesit. Ideja e komisionit është që të përbëhet nga tetë anëtarë, katër nga Kuvendi. Të respektohet kuota gjinore. Nuk është se ka ndonjë punë kështu, që me marrë vendime. Po thjesht është punë monitoruese, që do të bëhet këtu. Po i lexoi rekomandimin Kuvendit. Katër anëtarë i zgjedh Kuvendi, një anëtar nga koalicioni qeverisës, një anëtar nga opozita dhe një anëtar nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, në këtë rast boshnjak. Pastaj vazhdon me një anëtar të shoqërisë civile nga personat me aftësi të kufizuar, një anëtar nga shoqëria civile për të drejtat e njeriut, një anëtar nga komuniteti i kulturës i minoritetit turk, dhe prej komunës përfaqësuesja e zyrës për të drejtave të njeriut nga komuna e Prizrenit, pra katër, si dhe katër nga shoqëria civile. Edhe një anëtar nga shoqëria civile e komunitetit turk. Këto janë propozimet

Alush Shala: Në KPF, edhe sponsorizuesi i kësaj Fisniku ka kërkuar që në këtë komision mundësisht të jenë njerëzit që janë të përfshirë dhe që kanë dijeni më shumë për të drejtat dhe liritë e njeriut. Edhe është mirë që edhe ju më thëne këtu që secili grup parlamentar, ata që i propozon të kenë më shumë dije në fushë. Kështu më duket jemi marrë vesh.

Shukri Quni: Ec Ma Ndryshe ka pas edhe një kërkesë më herët, për mu heq rrethoja e Kuvendit komunal. E kështu që është mirë që edhe kjo rrethojë me fillua mu heq, pasi që ne do ta votojmë këtë kartën e qytetit. Besoj që ka mu duk edhe më mirë Kuvendi komunal, sepse ka qenë kërkesë edhe e VV-së. Mu banë një park i mirë këtu te Kuvendi, e jo mu mbush me kupëza e parkingje që e keni bo.

Kryesuesi: Atëherë kalojmë te propozimi i grupeve parlamentare për këtë komision.

Simir Krasniqi: Ne e mbështesim plotësisht këtë iniciativë. Ne e propozojmë Rreze Hoxhën, pasi që është edhe kuota gjinore 50-50%.

Adem Shabanaj: Ne nga koalicioni qeverisës e propozojmë Ilir Gashin.

Edis Aljilji: Mi predlžemo da bude Memnuna Ajdini.

Kryesuesi: Memnuna Ajdini. Dhe përfaqësuesja për të drejtat e njeriut, nëse nuk gaboj në ekzekutiv duhet të jetë grua në këtë rast, dy me dy. Po ashtu propozimet e shoqërisë civile do ta kenë parasysh edhe këtë faktin e kuotës gjinore. Emrat ti dërgojnë në formë të shkruar, në zyrën e Kuvendit. Ose ne po marrim vendim për themelim, ku të përcaktuar në këtë rast janë vetëm anëtarët e Kuvendit.

Ganimete Hoxha Babuna: Ne paraprakisht nuk jemi dakordua që të jepet një emër nga pozita. Mirëpo, në këto takime që i ka bo Ec Ma Ndryshe, gjithmonë në çdo takim ka marr pjesë Lirija. Kështu që është në rrjedha për këto gjëra. Kishte me qenë mirë me shkua Lirija.

Adem Shabanaj: Propozimi në emër të koalicionit u dha, është Ilir Gashi.

Kryesuesi: Atëherë 34 anëtarë janë prezent në sallë, e hedh në votim themelimin e këtij komisioni, si dhe votimin e këtyre emrave që u propozuan, kush është për?

Për? – 29.

Kundër? – 1.

Abstenim? – 4.

Atëherë konstatoj se me 29 vota, për 1 kundër dhe 4 abstenime miratohet karta e qytetit si dhe themelohet komisioni që e monitoron këtë dokument.

Shukri Quni: Kryesues, për kartën e qytetit edhe unë kisha votua. Për emrat jam kundër, se u shkel e drejta e një femre.

Kryesuesi: I nderuar, këtu komisioni kërkon përbërje gjinore. Nga opozita e morëm propozimin e shefit të grupit. Nga koalicioni u dha propozimi. Çështje tjetër është që, a janë marrë vesh a nuk janë marrë vesh. Këtu është përfaqësuesi i koalicionit. Është marrëveshja se si është bo. Ju kisha lutur herëve tjera, kur vinë dokumentet, paraprakisht takohuni dhe konsultoheni. Se

kjo nuk është çështje e Kuvendit, se a jeni marrë vesh apo jo. Emrat u thanë, nuk ka këtu punë aq të madhe se që po mendohet mu bo. Është një përfaqësim nga Kuvendi dhe natyrisht ne do të kemi edhe komisione tjera. Besoj që të gjithë do të jeni të përfaqësuar. Pra, mos ta bëjmë në punë e cila nuk është problem. Vazhdojmë me rendin e ditës. Përfundoj kjo çështje veç se është miratua kjo.

Ilir Baldedaj: Jo kryesues, mos i përfundo çështjet në këtë formë. Të lutëm, edhe para votimit e kam qua dorën, nuk ma jep fjalën. Tu kisha lut të je më i vëmendshëm në këto çështje. Sepse kur e thua çështjen e opozitës. Partitë e opozitës janë të ndara kryesues. Ose është dashtë me bisedua, me ja dhënë mundësinë subjekteve të ndryshme, ta kenë nga një anëtar. Nëse ja ke dhënë opozitës, ja ke dhënë PDK-së. Ta ke të qartë këtë çështje. Të kesh vëmendje, se ne po i ngremë duart dhe ti po vazhdon me agjendën tënde. Agjendën e Kuvendit ne e përpilojmë. Tu kisha lut, sepse tash nuk mundesh me i votua dy çështje. Po e voton edhe kartën edhe komisionin. Janë të ndara bre kryesues. Të dyja janë të ndara.

Kryesuesi: Unë kërkova deklaratimet e shefave të grupeve. Edhe e keni pa dokumentin e keni lexua që krahas miratimit të kartës, vije edhe obligimi i themelimit të komisionit. Ju kisha lut që herëve tjera lexoni me kujdes dokumentacionin. Edhe mos e boni problem një punë, që realisht nuk është edhe problem. Nëse problemi i juaj të nderuar anëtarë të Kuvendit është mos koordinimi në kuadër të bllokut pozitar ose opozitar, për besë nuk di çka me ju thënë. Lexoni ju lutëm dhe ejani të përgatitur për mbledhje të Kuvendit.

Baldedaj: Kryesues, ekzistojnë procesverbalet ke thënë. Kërkoj mbështetjen e grupeve parlamentare për çështjen e kartës. Nuk ke thënë për çështjen e komisionit. Janë të ndara.

Haziz Hodaj: Nga të dy anët nuk është mirë. Ne e thamë propozimin, por e dhamë për kartën e qytetit. Edhe për ne si grup shumë më e rëndësishme është aprovimi i kartës së qytetit, se sa një komision që do të veproj. Unë për këtë në mbledhjen atë ditë që e patëm me Ec Ma Ndryshe, u thash atyre që ata të propozojnë se ata kanë monitorua punën e Kuvendit vazhdimisht. Dhe i njohin mirë anëtarët e Kuvendit, se kush mund të veproj edhe kush mund të jap kontribut në këtë drejtim. E rëndësishme është që ky komision të jetë kompetent edhe të jetë një komision, që e njih problematikën edhe e përcjellë implementimin e kësaj karte. Përndryshe shumë pak e rëndësishme është se kush është në këtë komision. A e rëndësishme është karta e qytetit. Do më thënë

u dha prononcimi për kartën e qytetit e jo për komisionin. Si do të që të jetë ne u pajtuam dhe nuk reaguam. Që një anëtar i komisionit le të jetë nga blloku i pozitës. Po nuk është mirë, që në mënyrë arbitrare të votohet për njërin apo tjetrin, pa u marrë vesh me partnerët. Nëse mendohet mu bashkëqeverisje, ose edhe ana tjetër me bashkë bo opozitë, do duhej me pas një koordinim. Përndryshe le të jetë kjo mësim për herët tjera.

Alush Shala: Edhe unë tani po detyrohem me u bashkua me kërkesat e këtyre të drejta. Sepse sipas kësaj që po shihet, për kartën e qytetit janë të gjithë. Andaj tu jepet mundësia që ta votojnë apo mos ta votojnë edhe njëherë kartën e qytetit. Që tani po shihet që do ta votojnë të gjithë. Sepse Shukri Quni u deklarua publikisht edhe unë jam kundër këtij komisionit. Përndryshe nuk është kundër kartës së qytetit. Andaj ndoshta nuk është e tepërt, që ti ja japim mundësinë ndoshta edhe që abstenuan të votojnë pro kësaj kartës së qytetit.

Shukri Quni: Unë kryesues kur tha që ta lexoni. Shumë mirë e kam lexua edhe e kam analizuar mirë. Edhe u kërkua për këtë debat. Por ju e përmbyllet menjëherë që mos me ardhur deri te kjo. Për kartën e qytetit secili kuvendarë këtu është për. Edhe nuk besoj që është dikush kundër. A sa i përket komisionit, i qite të dyja në votim. Unë thash jam kundër komisionit, jo kartës. Edhe kështu që është mirë që kur të vinë pikat që kemi mi diskutua, le të debatohet sepse për këtë jemi ne këtu. E nuk ka nevojë me thënë kështu leksioni, se a lexohen materialet apo. Se besoj se secili që vjen këtu i lexon materialet.

Kryesuesi: Unë kërkova propozimin që në këtë rast e dha shefi i grupit tuaj, që e jep qëndrimin zyrtarë. Po ashtu ju deklaruat me votë që jeni kundër, dakord. Nuk e di pse po bëhet problem për diçka që s'ka nevojë u bo problem. Ne e patëm mundësinë, po shumica e anëtarëve të Kuvendit ishin që s'ka nevojë mu prezantua, se ndër të tjera ishte sqarua pastaj këtu. Ndoshta gabimi është i imi për shkak se po e lë në diskutim edhe vullnetin e Kuvendit, se si me shkua rrjedha. E nuk po iu përmbahem ndonjëherë rregullave edhe zakoneve të Kuvendit. Ne e dimë se si shkon puna. Hapet pika e rendit të ditës. Vjen propozuesi, qoftë nga Kuvendi, qoftë nga ekzekutivi apo shoqëria civile. E bënë prezantimin edhe aty dalin obligimet. Por kur thuhet që jo po kalojmë direkt me shefat e grupeve, e mandej po mbeten të pa informuar. Se krahas themelimit të komisionit, vije edhe çështja e miratimit të kartës. Që të dyja shkojnë bashkë në votim. Është vendim që në vetvete përfshinë krejt këtë tërësi.

Haziz Hodaj: Tjetër është aprovimi i kartës, që është e rëndësishëm për Prizrenin, tjetër është zgjedhja e komisionit. Këtë do duhej më nda. Po ne u pajtuam nuk është problem, se është çështje teknike. Po do duhej fillimisht me aprovua dokumentin, e mandej me zgjedh komisionin. S'ke nevojë tjetër, gabim s'ke ti. A pranon debat a s'pranon, Kuvendi vendos, kjo është çështje krejt teknike.

Sinan Alija (Nisma): Unë së pari e përshëndes këtë iniciativë prej kësaj organizate. Mirëpo, desha më thënë kjo organizatë, të emërimi Ec Ma Ndryshe, unë di që kur i kemi pas nga një vit jemi mësuar me ec. Është mirë mi thënë organizatës që emrin me ja ndërrua. Se jemi të vetëdijshëm me këto që jemi edhe e dimë kah orientohemi, kah shkojmë. Tjetra karta e qytetit, e drejta mbi qytetin e Prizrenit. Kush dinë me ma dhënë shpjegimin e kësaj, mbi çfarë të drejte, roli i kësaj karte që ka ardhur prej kësaj organizate, do të jetë i rëndësishëm së ekzekutivit. Cila është e drejta e tyre të bazohet në ligje, në nene apo në rregullore, se nuk e kam fort të qartë. Sa i perkat pastaj pika të vendosura që janë të përcaktuara, janë gjëra të përsëritura edhe monotone. Unë edhe në parim e votova. Mirëpo, është mirë ai komision që bëhet, ta bëjë një analizë të mirë, në praktikën që e ka ndjek kjo organizatë.

Ilir Baldedaj: Kryesues unë kisha kërkuar që të thirret edhe njëherë në votim. Të ndahet çështja e kartës me komisionin, sepse nuk shkojnë të dyja bashkë.

Kryesuesi: Faleminderit, mirëpo veç se është mbajtur një votim për këtë çështje. Të gjitha sugjerimet dhe këto vërejtje që u dhanë të anëtarëve të Kuvendit, do ti kemi parasysh në rastet e ardhshme. Ndoshta kjo ke gabimi për shkak se nuk u lejua një prezantim në fillim. E kuptueshme kjo punë. Por do ta bëjmë herën tjetër. Prapë po them nuk është kjo ndonjë problem. Vazhdojmë se tashmë e kryem procedurën e votimit.

Pika e pestë:

Diskutim për Raportin financiar të Komunës së Prizrenit, për periudhën janar-shtator 2018.

Ju e dini që sipas obligimeve që dalin nga ligjet në fuqi, kuvendi komunal në mënyrë periodike diskuton raportet financiare apo të shpenzimeve çdo tre muaj. Për këtë çështje e kemi të ftuar edhe drejtorin e Financave, ku do ta bëjë një prezantim të raportit, pastaj e hapim diskutimin për anëtarët e Kuvendit.

Ertan Simitçi, drejtor i Drejtorisë për Financa: Siç e tha edhe kryesuesi, edhe Drejtoria e Financave edhe komuna e Prizrenit ka një obligim ligjor të shqyrtoj apo të njoftoj Kuvendin, në kohën sipas afateve ligjore. Materialin lidhur me raportin janar-shtator 2018, e keni marrë po më duket me kohë. Po sot i kemi shpërndarë këto materialin fizikisht, për shkak se votimi është vonua pak. Sipas raportit të Drejtorisë së Financave, Grandi qeveritar gjatë periudhës janar-shtator 2018 është alokuar në shumën prej 30.800.000 € Pra 85% e shumës së planifikuar për tërë vitin sipas planifikimit 36.400.000 € Shuma e shpenzuar nga ky burim i buxhetit komunal është 23.794.504 € ose 65% e shumës së paraparë për vitin 2018. Në këtë periudhë janar-shtator të raportimit të hyrave vetanake janë alokuar në shumën prej 4.585.309 €, ose 56% nga planifikimi prej 8.100.000 € Nga ky burim janë shpenzuar rreth 2.226.962 €, ose 49% e shumës së alokuar. Në këtë periudhë nga kategoria e të hyrave nga donatorët e jashtëm janë alokuar 247.974 €, ndërsa janë shpenzuar deri më tani vetëm 1.000 € Të ardhurat totale, apo të hyrat e përgjithshme të alokuara të buxhetit të komunës për nëntë muaj janë 39.500.000 € Nga planifikimi 48.700.000 € dhe janë shpenzuar 27.800.000 €, pra 57% e shumës së planifikuar ose 71% të shumës së alokuar. Të hyrat vetanake komunale, shuma e arkëtuar deri në fund të shtatorit ka qenë 5.168.805 €, pra 64% e shumës së planifikuar për vitin 2018. Në këtë periudhë të vitit 2018, të hyrat vetanake janë alokuar në shumë prej 4.500.000 € dhe janë shpenzuar 2.226.962 €, ose 27% të shumës së planifikuar. Realizimi i të hyrave sipas kategorive, është i kënaqshëm me kategoritë, të pagesave në lidhje me automjetet me 95%. Tatim në pronë 75%. Menaxhimi i mbeturinave 64%. Shërbimet e inspektimit të shëndetit dhe sigurisë 64%. Ndërsa realizimi i të hyrave është jo aq i kënaqshëm në realizimin e të hyrave tendencat komerciale dhe të biznesit me 22%. Shfrytëzimi i pronës komunale me 43%. Dhe të hyrat nga arsimi me 45%. Në faqen nëntë që e keni në material, e keni edhe pasqyrën krahasuese me vitin e kaluar. Do më thënë vitin 2017, krahasim me vitin 2018. Sipas krahasimit janar-shtator 2018, të hyrat vetanake kanë pësuar një rënie rreth 424.594 €, ose 7.6%. Por duhet të cekët këtu që në vitin 2017 ka qenë planifikimi 6.100.000 € Ndërsa këtë vit e kemi 8.100.000 € Do të thotë 2.000.000 € është planifikimi më i madh në krahasim me vitin e kaluar. Shpenzimet e buxhetit komunal, në kategorinë e pagave rreth 73% në realizim sipas planifikimit. Në mallra dhe shërbime janë shpenzuar 3.343.276 €, ose 65% e shumës së alokuar. Shpenzimet komunale 69% sipas shumës së alokuar. Shpenzimet sipas kategorisë të subvencioneve është 419.664 €, ose 79% e shumës së alokuar. Gjatë periudhës janar-shtator 2018, realizimi i investimeve kapitale ka arritur rreth 9.000.000 €, ose 50% prej shumës së alokuar, prej 18.100.000 € Shpenzimet e përgjithshme të komunës së Prizrenit deri në fund të shtatorit kanë arritur rreth 27.800.000 €, ose 71% të

shumës së alokuar. Të hyrat nga grandit i përgjithshëm janë alokuar 30.800.000 € Dhe deri në shtator janë shpenzuar 23.800.000 €, ose 77% e shumës së planifikuar. Ndërsa në të hyrat vetanake deri në shtator janë alokuar 4.500.000 €, ndërsa 2.200.000 € janë shpenzuar. Në kategorinë e investimeve kapitale nga grandit qeveritar janë planifikuar 12.800.000 €, 100% janë alokuar dhe 6.900.000 € është bërë një shpenzim deri në fund të shtatorit. Në të njëjtën kategori por të hyrat komunale, planifikimi është 4.900.000 € Ndërsa deri në fund të shtatorit janë alokuar 2.500.000 €, dhe rreth 800.000 € është një shpenzim. Në faqen 13 mund të shikoni, është raporti sipas shpenzimeve në krahasim me vitin e kaluar. Janë edhe përqindjet. Sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, është edhe afati i fundit për zotimin e mjeteve. Nga kategoria e investimeve kapitale është deri më 31 tetor. Ne si Drejtori e Financave i kemi bërë të gjitha përgatitjet, që të zotohen të gjitha këto mjete që janë prej grandit qeveritarë në kategorinë e investimeve kapitale, për tu shfrytëzuar ky burim. Ndërsa kemi marrë disa masa konkrete që edhe të hyrat vetanake të realizohet rritja e inkasimit e të hyrave vetanake. Për shkak se sipas planifikimit është e vërtetë që nuk jemi në realizimin e duhur në këtë kategori. Me këtë rast edhe dua të ju njoftoj që edhe dje e kemi pas një takim me media, që me 1 tetor ka hyrë në fuqi edhe tatimi në pronë, i cili na obligon, që të gjitha komunat të fillojnë me procedurat e inkasimit të detyrueshëm. Për këtë arsye është edhe mundësi e të gjithë qytetarëve, që kanë ata obligim në tatimin në pronë. Që të vizitojnë drejtorinë e financave dhe të konsultohet edhe me zyrtarët aty dhe të shikojnë mënyrat apo metodat e kushteve së pagesës. Të gjitha ato analizat tjera shpenzimet dhe të hyrat e kemi në raport. Për çdo pyetje apo sqarim jemi këtu.

Sherife Balaj: Ishte një prezantim i qartë besoj për të gjithë. Unë po e bëj një analizë të përgjithshme. Po ti krahasojmë të hyrat e buxhetit të periudhës janar-shtator dhe shihet qartë se kemi një dallim të madh të realizimit të këtij buxheti. Periudha e realizimit janar-shtator të 2018 nga grandit qeveritar të alokuara kemi 30.000.000 € Nga kjo vlerë janë shpenzuar 23.000.000 €, ose diku 65%. Po të njëjtën periudhë të vitit 2017 nëse e krahasojmë me përqindje i bie 80% të realizimit. Pra, shihet qartë realizimi i këtij buxheti. Ndërsa tek të hyrat vetanake e shprehu edhe vetë drejtori, se nuk jemi mirë me këto të hyra vetanake. Dhe kemi pasqyrën krahasuese të vitit 2018-2017. Faqe 9 tabela 5 e shprehur në përqindje. Kemi të bëjmë me një ndryshim të madh. Kjo të jep me kuptua për menaxhimin e mirë dhe të suksesshëm të vitit 2017. Të shpenzimet e buxhetit komunal, po ashtu edhe këtu kemi dallime sa i përket shpenzimeve të buxhetit. Kemi shpenzime të buxhetit në fund të shtatorit, e janë 27.000.000 € ose 70%. Nga 39.000.000 € të alokuara. Po të njëjtën periudhë të viti 2017, kemi të shpenzuara 26.000.000 €, ose shprehur në përqindje kemi 77%. Nga

34.000.000 € të alokuara. Pra, shihet qartë sa është diferenca në mes 2017 dhe 2018. Po ta shikojmë tabelën 8 faqe 14 se në cilat kategori kemi qenë me përqindje më të madhe të mallrat dhe shërbimet dhe subvencionet. Ndërsa të shpenzimet sipas kategorive dhe drejtorive për periudhën janar-shtator 2018. Nuk e kemi të njëjtën pasqyrë edhe të vitit 2017 për me bo një krahasim. Dihet se edhe aty është një krahasim i dallueshëm. Me përqindje shumë më të mëdha të vitit të kalua se sa tash. Edhe një shqetësim tjetër i përgjithshëm. Mbi 100.000 € ose ndoshta edhe e arrin edhe 200.000 € për mbështetje financiare. Pse nuk janë të sqaruara ku janë ato mbështetje financiare, sikur nëpër kategoritë e tjera. Se kanë shkua p.sh. mbështetje financiare ta zëmë shpenzimin e varrezave, apo ku e di unë ndonjë shpenzim tjetër. Ndërsa këtu veç e dimë kodin ekonomik mbështetje financiare. Çka mbështetje financiare? Nuk e kam të qartë, na tregoni ku janë shkua këto para? Për mbështetje financiare të secila drejtori ka shuma të ndryshme. Ta zëmë të Drejtoria e Mirëqenies Sociale po më duket mos gabofsha janë 10.000 € mbështetje financiare. Kur të gjitha kategoritë e tjera janë pasqyrua me emra, ku janë shpenzua. Ndërsa për mbështetje financiare të secila drejtori, e ke me shifra të mëdha, 59.000 € po më duket të Drejtoria e Shëndetësisë mbështetje financiare. Çka mbështetje financiare! Subvencione e qartë, po çka me emër.

Ilir Baldedaj: Për që nuk dini me inkasua të hyrat e komunës, sinqerisht e kam ditë këtë. Por që dini kaq mirë me harxhua luks, se kam besua. Sepse një qeverisje që nuk dinë me inkasua mjetet, por dinë me shpenzua mjete në luksin e vetë. Kjo tregon që këta kanë ardhur vetëm për luks edhe për apetitet e tyre personale. Por nuk kanë ardhur për të qeverisë për qytetin dhe me hallet e qytetarëve të Prizrenit. Drejtori i Financave edhe në atë kohë ka qenë drejtor, por inkasimin dhe të hyrat vetanake i ka pas shumë më të mirë se sa ky sot. Unë nuk besoj se ky është faj i drejtorit, sepse e di përkushtimin dhe punën e tij. Por faji është i të parit, sepse ai nuk e dinë se çka është inkasimi i mjeteve. Ai e dinë vetëm me lëvizë, me keqpërdorë buxhetin, në mëditje dhe udhëtime zyrtare. Po u bo një vit, le të na tregon kryetari i komunës, nga vizitat e tij që i ka pas. Nga shpenzimet e taksapaguesve të qytetarëve të Prizrenit. Çfarë të mire i ka sjellë qytetit të Prizrenit? Cilat janë rezultatet që i ka arrit? A ka pru ndonjë fabrikë, a ka pru ndonjë donacion të jashtëzakonshëm në Prizren? Apo ndoshta ka qenë veç për ekskursion, mi marrë disa drejtorë, që ndoshta në jetën e tyre se kanë kalua Prizrenin kurrë. Edhe mi qua ne ndonjë vend turistik me pa që ndryshon pak më ndryshe Prizreni. Sepse gjysma e drejtorëve në jetën e tyre s'kanë menaxhua as një trafik, e lëre më të menaxhon me një buxhet të taksapaguesve të qytetarëve të Prizrenit. Andaj po më vjen keq që gjysma e pushtetit që kanë kritikua nuk janë këtu. Aq më keq kur ky i famshmi i qebapëve qëndron në

kryesi dhe është kryesues i asamblesë komunale. Po insha Allah i ka ra në gojë ndonjë qebapë se bajagi mirë keni shpenzua kryesues.

Kryesuesi: Faleminderit Ilir. Unë nuk shquhem që ha shumë, duket. Sido që të jetë faleminderit për vërejtjet.

Shukri Quni: Unë desha me pyet a i keni paguar borxhet që i ka lënë qeveria e mëparshme. Se ka qenë shumë kërkesë edhe e juaja, që operatorëve nuk i kanë pagua borxhet. Kështu që edhe borxhet nuk janë pagua dhe po shihet që do të shkoni në suficit. Sepse në bazë të alokimit ju diku ja 7.000.000 € qysh po shihet deri në fund të vitit, kanë me mbet suficit. Se diku janë planifikuar 30.240.330 € do më thënë 85%. Ndërsa janë harxhua 23.794.504 € E këtu tash diku 7.000.000 € deri në fund të vitit po e shoh se do të ju shkojnë edhe juve në suficit, sikur që i kanë shkua edhe qeverisë së mëparshme. E tha edhe Iliri qaj drejtor je edhe tash. Por nuk e di pse tash nuk ke kritika prej ish- opozitës. Po më vjen mirë që po të lëvdojnë bile ty. Edhe shpenzimet nuk i keni lënë mangu. Edhe të hyrat vetanake janë parapa 8.829.284 € janë harxhua 4.585.309 € Do më thënë ju kanë mbet edhe 2.226.962 € Kjo është sipas llogaris sime. Unë kërkoj sqarime, sepse unë nuk jam për me shkua në suficit. Këtu e kam, që mjetet të cilat janë grumbullua, sikur që na kanë shkua vitet e kaluara 3.000.000 e 3.600.000 € prapë jem mundua mi kthye, aty e kam unë. Se që paguhen borxhet dhe që investohet hallall të qoftë, sepse ne për atë jemi. Te shpenzimet brenda vendit 138.124 € Ku janë këto. Hajde jashtë vendit janë 14.437 € këto po dihet që kanë shkua jashtë. Mirëpo këto brenda vendit ku kanë shkua. Mëditjet e udhëtimit për zyrtarë jashtë vendit. A ka mundësi me ditë që kryetari Prof. dr. Ramadan Muja, a ju ka pagua mëditje kur kanë dal jashtë. Unë e di që nuk ka pagua kryetari në këtë drejtim. S'po di tash ju sa... A ju ka pagua a!. Ani mirë nëse ju ka pagua, unë nuk po kërkoj... Unë tash e bëra një pyetje, ani mirë le të përgjigjen. Shpenzimet për anëtarësim, Artan na ke pas bërë pyetje edhe më herët. Çka është këtu 18.378 €, a keni anëtarësua dhe ju në LVV-je me para a! A të kujtohet kur na ke bo këtë pyetje, çka është kjo, kënd e keni anëtarësua. Pastaj mobiliet më pak se 1.000 €, 29.763 €i keni heq ato të vjetrat i keni vu të rejat ndoshta. Po mirëmbajtja e mobilieve, a kaq shpejt i keni prish 26.633 € mirëmbajtje. A i keni gjet të shkatërruara, a i keni ndreq, po të rejat ku i keni qua. Ti s'je në gjendje me na bo ka një përkthyes, që shumë po më vjen keq prej kolegëve këtu që s'janë në gjendje ti kuptojnë. Po ashtu edhe për dreka zyrtare keni kritikuar shumë. Dreka zyrtare 34.000 € për nëntë muaj. Unë e di që ti ke ra zaif, po këta tjerët kanë fillua ka pak me marr dhjam. Dreka zyrtare i ke 30.206 € Llogarite tash edhe këto janë ushqim 64.000 € Edhe këtu ka nevojë dikush me shkua te mjeku se s'është puna mirë Artan. Vizitoni ka pak këta! Karburante për vetura 25.000 € Ka pas than kolegu Haziz Hodaj, tha më mirë me ardhur me taksi se sa me vetura. Se janë edhe mirëmbajtja edhe riparimi i

automjeteve 47.554 € Kur i llogaritë këto tash, më mirë më të vërtetë me ardhur me taksi punëtorët se sa me ju dhënë makinat. Qysh tha më herët Iliri, tha i kanë heq edhe ato shenjat e komunës. Insha Allah mos i kthejmë me shenjë të re ndoshta po i vendosim në makinat e komunës. E këtu tash e di që keni me thënë, këto janë gjykatat që i keni lënë ju. Veç këtu është në pyetje 1.000.000 € U tha për karburante edhe për mirëmbajtje të makinave i ke diku 25.268 € plus 47.000 € do më thënë afër 70.000 € Shpenzimet dhe vendimet e gjykatave 156.582 € Ndoshta jeni duke i paguar ato gjykatat që i kanë bo qeveria e mëparshme. Vendimi nr. 39.2 është 160.974 € Pagesa për vendime gjyqësore 338.316 € Plus pagesa sipas nenit 39.2, 349.274 € Se kam llogarit bash saktë po është 1.000.000 € Këto para vaj më det edhe kush ka qenë edhe kush jemi, që shkojnë këto para fill në lloç. Kjo është më të vërtetë me marrë të gjithë kuvendarët ka një shami në dorë me ja nis me kajtë. S'kemi çka me bo! Në rast se shkojnë këto vetëm për gjykata. Kolegë dhe qytetarë të Prizrenit nuk pres që keni me bo ndryshime aspak. Ndryshim kemi vetëm Artani ka qenë këtu te ne i ulur, ka dal atje në ballë, ky është ndryshimi nr.1. Edhe kogja ka ndryshua edhe në sjellje, se jo në shëndet, qashtu je. Unë sinqerisht po ju them kam prit shumë prej jush. Kam prit shumë ndryshime së bashku me të gjithë qytetarët. Nuk po e them këtë po politikë, sinqerisht e kam. Se i vetmi ju keni qenë që s'keni qenë në pushtet Artan. Të tjerët krejt çka jemi të ulur këtu kemi qenë në pushtet. Minoritetet si Nasradini këta, kushdo që të lëvizë këta në ballë i ke aty. Por kjo nuk po ndodh, po më vjen keq prej të gjithë qytetarëve sepse ndryshimet nuk janë duke ndodh. Pra, këtu është ka vjen qysh është keq e ma keq. Edhe kemi me prit një keqqeverisje, që ka me shkua prapë me suficit. Investime s'keni bo hiç. Jo keni pagua borxhe, jo s'di çka po thoni. Këtu është duke u pa që nuk është ka punohet. Tash mundeni me thënë ka dal bre se është fillimi, ja nisim vitin tjetër. Unë po ju tregoj mandati i parë kur e kemi marrë ne PDK-ja.

Kryesuesi: Shukri, e ke tejkalua kohën.

Quni: Vetëm pak, se kam të drejtë me fol, jo se kam kalua, se mi japin shokët, le atë punë tash.

Kryesuesi: Në emër të grupit.

Quni: Në mandatin e parë na kemi qenë për çdo lëvdatë, sepse kemi krye shumë punë. Edhe në mandatin e dytë, nuk ka kurrfarë ngecje që kanë ngec për mu realizua projektet. E ky i treti na tregoj edhe rezultatin, tash s'mundemi me marrë lëvdata. Edhe bajat bëhesh dhjet vjet me marr me sundua. Po ju ja keni nis risht. Ju nuk jeni duke këqyrë që këto mjete që merren prej qytetarit me i qua në vendin e duhur. Shkoni i boni do investim pa kurrfarë vlere. E di që shumica e projekteve janë realizua. Po ka nevojë edhe për investime tjera. E

kështu që drejtor, ti mos e merr barrën kush e di sa. Se të kanë kritikua ty edhe tash këta që janë në pozitë, ti ke qenë në opozitë. Ai drejtor je, nuk të kanë ndryshua fare. E kështu që pak ka ndryshim prej qeverisjes së kaluar ose hiç. I ke nja dy pozicione që i ceke ku ke arrit me e rrit atë. Po ke edhe ulje, jashtëzakonisht ka ulje. Aty ku komuna ka pronat e veta, edhe aty ku komuna i ka interesin e vetë. Aty s'keni mund me inkasua. Se u pa në ato drejtoritë kanë arrit, Inspektorati apo Shërbimet Publike. Po tjerët i ke ngecje. E kështu që mos të na shkojnë në suficit, por ti qojmë paranë aty ku më të vërtetë e meriton mu investua. Mos e ndani elektoratin. Se jeni duke zgjedh më duket kah mi qua tash, kah mi orientua.

Kryesuesi: I kisha lutur anëtarët e Kuvendit, që në pikat e rregullta të deklarohen paraprakisht se a po flasin në emër të grupit. Sepse minutazha dallon dhjetë minuta, apo në emër personal ku është pesë minuta.

Sadije Osaj- Jakupi: Duke e ditë se jemi dëshmitarë të kohës të gjendjes sociale këtu tek ne, mua më ra në sy tabela faqen 9 tabela nr. 5. Të ardhurat nga shërbimet sociale. Planifikimi në vitin 2018 është 15.000 € ndërsa realizimi është 10.000 € Për vitin 2017 të planifikuara nuk kemi, ndërsa të realizuara 1.335 € Gjë që skadon me një ndryshim shumë të madh. A thua në vitin 2017, nuk kemi pas raste sociale dhe nuk është punuar asgjë. Meqenëse dyshimi është shumë i madh.

Bardhi Avdaj: Pak po dal prej temës se nuk isha në sallë ku Agnesa më kishte repliku. Po më vjen mirë që diskutimi për Abetare ka me vazhdua. La Shuk, emri im është përmend, të respektoj edhe desha me të respektua s'desha me fol. Po kjo nuk ka të drejtë me ma përmend emrin. Se i kam 800 vota. Pranverim Berisha i ka ofendua drejtorët e Vrrinit. Nuk ka të drejtë askush me i ofendua njerëzit e Vrrinit. Unë kam të drejtë me fol, nuk ka të drejtë me ma ndal fjalën, as kryesuesi as askush nuk mundet me ma ndal fjalën, kur më takon me fol dy minuta. Por Agnes ta kesh parasysh, herën tjetër ty kam me ta pru edhe Abetaren edhe krejt këto vizatime, e vizore.

Kryesuesi: I nderuar, jemi te raporti i shpenzimeve.

Avdaj: Nëse të ka mbete hatri, ta kesh parasysh, seancën e ardhshme me Abetaren kam me ta pru, edhe ato të klasës së parë, edhe një çantë kam me ta pru. Edhe ja fillosh edhe ti me lexua Abetaren.

Alush Shala: Gati thuaja u thanë të gjitha nga parafolësit. Për atë që kam mendua edhe unë me thënë. Por po më vjen keq nga ju, pse nuk i boni ftesë, apo është krejt pa vlerë kjo pikë e rendit të ditës për juve kryesues dhe për VV-në në veçanti. Të cilët pos Ilirit që po merr pjesë të gjithë kanë dal. Edhe thuaja tërë kohën ishte salla bosh. E asnjëherë nuk bëtë thirrje që të kthehen, sepse po pinë cigare, ose kafe jashtë. Nuk e di, a aq e keni nënvlerësuar këtë pikë të rendit të ditës, apo si është puna! Andaj, ose ndërprerje seancën dhe ta llogaritim që kjo pikë e rendit të ditës nuk vlen të diskutohet. Edhe nëse bëhet pyetje për milionët që tha edhe zonja Sherife të qytetarëve të komunës së Prizrenit. E këta e injorojnë në këtë mënyrë, nuk e di a jemi në rregull a jo. Ose të na liron të gjithëve. Për të tjerat i thanë edhe parafolësit, nuk dua ti përsëriti. Pajtohem thuaja plotësisht me të gjithë.

Ilir Baldedaj: Desha ta pyes drejtorin se çka nënkupton me furnizimin me dokumente blanko. Se edhe në raport në tremujorin e parë e kemi pas këtë shqetësim. Dhe e kemi ngritë, po s'kemi marrë përgjigje. Ndërsa te kompjuterët më pak se 1.000 € Shuma është 10.270 € Sa kompjuterë janë ble drejtor, se sinqerisht është vlerë e madhe.

Dafina Billaca: Në faqen 9 tabela 5 ku është pasqyra krahasuese e planifikimit të realizimit të të hyrave vetanake për vitin 2017-2018. Po shihet qartë planifikimi i vitit 2018 është 8.100.000 € ndërsa realizimi është 5.100.000 € Që i bije vetëm 60% e planifikimit. Ndërsa në vitin 2017 është realizuar 92%. Kjo do të thotë që është duke u dëmtuar buxheti i Prizrenit. Po shihet qartë se ju jeni shumë larg nga qeverisja e kaluar. Dhe madje as nuk mund të krahasoheni në këtë aspekt. Sepse qeverisja e kaluar të hyrat vetanake, i ka pas mjaftë të kënaqshme, krahasuar me ju. Të gjitha u thanë, por më shumë që po më vjen keq është nga kuvendarët e koalicionit të po heshtin, ku në brendësinë e tyre, ndihen shumë bashkëfajtorë. Pse nuk e kritikojnë këtë që po ndodh me buxhetin e Prizrenit. Sinqerisht po më vjen keq shumë, kur po i shoh këta që janë këtu, po edhe ata që kanë dal jashtë.

Ertan Simitçi: Znj. Sherife Balaj e patë një pyetje, për mbështetje financiare. Është e vërtetë që të gjitha subvencionet që i jep komuna, është në kategorinë e mbështetjeve financiare. Edhe ashtu ceket. Jo, ajo është totali. Është sipas kodit sipas sistemit qysh del. Se të gjitha subvencionet janë mbështetje financiare. Nëse e keni qëllimin analitiken, mundeni me bo kërkesë në Drejtorinë e Financave, ju japim menjëherë raportin e shpenzimeve. Iliri pat një sqarim lidhur me inkasimin. Komuna e Prizrenit është e vërtetë që ka pasur edhe në vitet e kaluara problem me inkasimin e të hyrave. Nëse e bëjmë një

krahasim me vitin 2015-2016-2017. Edhe te planifikimi ka qenë problem, po edhe te inkasimi. Krahasimin kur e bëjmë për vitin 2017-2018, është rreth 430.000 € një diferencë. Që sivjet jemi më pak. Po të dimë edhe diçka, që Urbanizmi që është ndoshta edhe drejtoria e tretë, që e ka planifikimin më të madh. Në qershor ka fillua me bo inkasimin për lejet e ndërtimit. Deri më tani rreth 54% Drejtoria e Urbanizmit. Po është e vërtetë që kemi probleme këtu. Po në disa kategori edhe te tatimi në pronë edhe te taksat komunale për biznes, edhe te shfrytëzimi pronës, janë problem që kemi bo kërkesë te kryetari, që të marrim masa konkrete. Që deri në fund të vitit të rritet kjo shumë. Por ta dimë diçka që në vitin 2017 komuna e Prizrenit, në vend, në shtete ka qenë në inkasim 117%, sipas planifikimit. Por këtu ka qenë edhe planifikimi 6.100.000 € Nëse e bëjmë një krahasim me vitin 2016 ka qenë planifikimi 8.400.000 € Edhe në fund të realizimi ka dal 65%. Do më thënë kur ta bëjmë edhe një analizë, dojmë me shqyrtua ose sipas planifikimit me bo një krahasim, ose sipas inkasimit me vitet e kaluara. Shukri Quni pat një pyetje për borxhet. Të gjitha borxhet e viteve të kaluara, operatorët ekonomik janë paguar. S'ka vetëm një pjesë janë që nuk janë të rregulluara dokumentet. Jemi duke i shqyrtuar ato. Besoj që deri në fund të vitit kryhen. Është po më duket afër 200.000 € një shumë, që nuk kemi mund me paga për shkak të mungesës së dokumentacionit. Ju japim përgjigje me shkrim, e shihni përgjigjen e saktë. Borxhet e vitit 2017 i kemi krye me realizimin e të hyrave të bartura prej të vitit të kaluar. Edhe unë jam me ju që suficit prej grandit qeveritar mos të ketë hiç. Se është e vërtetë që këto mjete duhet të shpenzohen. Shpenzimet brenda vendit është rreth 220.000-apo 240.000 € duhet me qenë. Se aty janë të gjitha shpenzimet e udhëtimit të arsimtarëve, nxënësve dhe të tjerë. E kemi njëfarë kontratë me firmën, që e kontraktun edhe është ajo pagesa. Udhëtimi jashtë vendit është raporti, mundem me ju dërgua. Është e vërtetë që sivjet edhe qeveria lokale edhe si komunë kemi pasur shumë vizita jashtë vendit. Po sigurisht edhe rezultatet do të realizohet ndoshta në këtë mandat. Pyetet për pagesën e anëtarëve. Nuk është kryetari që vendos, a mu paga për anëtarë, apo jo. Ligji e vendos, është udhëzimi administrativ edhe ajo e rregullon. Mundem me ju lexua kartelën kush ka marrë mëditje edhe prej Kuvendi po edhe prej menaxhmentit. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve vitin e kaluar ka qenë 51.770 € Sivjet është 47.554 € Karburante për vetura në periudhën janar-shtator në vitin 2017, 102.362 €, ndërsa në vitin 2018, 25.268 € Dreka zyrtare në vitin 2017, 7.646 €, në vitin 2018. 30.301 € Edhe në raportimin e gjashtëmujorit ju kom njoftua që sivjet kemi pasur shumë problem të subvencionet. Në vitet e kaluar disa OJQ, na kanë kërkuar mbështetje financiare dhe sivjet e kemi bo një ndryshim. Pasi që e kemi ne kodin për dreka zyrtare. Mos me ju dhënë direkt OJQ-ve direkt subvencion për një takim që e patën për

aktivitete për me zhvillua. E kemi bo me vendim të kryetarit, me procedura që të paguhet prej kodit dreka zyrtare. Do më thënë nuk është kjo 30.000 € total shpenzimi i qeverisë. Janë raportet, nëse ka nevojë edhe kjo me kërkesë ju drejtohet juve. Furnizim me pije, ushqim me dreka zyrtare. Në vitin 2017 ka qenë 17.200 € Sivjet është 33.933 € Edhe këtu që i kemi pasur disa aktivitete më herë që janë bërë me procedura i shfrytëzuar me firmën që e ka kontratën për furnizim për dreka zyrtare. Furnizim për zyre në vitin 2017, 139.445 € Në vitin 2018, 144.381 € Këtë e kam për janar-shtator. Problem që patëm edhe në fillim të vitit edhe ende kemi problem. Janë për pagesat e 3+3 pagat e punëtorëve që kanë qenë në arsim. Jo vetëm komuna e Prizrenit po krejt Kosova për momentin e problemin e njëjtë. Se është një shumë e madhe. Ne me këtë buxhet të pagave që na detyron Ministria e Financave. Nuk kemi mundësi me i pagua pagat për këto kompensime për mes kategorisë së pagave. Edhe të gjithë këta që kanë qenë punëtorë të komunës qoftë të administratës, të arsimit apo të shëndetësisë, obligohen me shkua me vendime, apo me procese gjyqësore që të kompensohet kjo. Vendimet e gjykatës, në kategorinë e mallrave shërbimeve në vitin 2018, ka 156.582 € Ndërsa me nenin 39.2, 160.974 € Të shpjegoj edhe diçka, që neni 39.2 është që të gjithë operatorët që nuk mundën me kompensua pagesën brenda 60 ditëve, kanë të drejtë me bo kërkesë në Ministrinë e Financave, në departamentin e thesarit. Vendimet gjyqësore në investimet kapitale, në vitin 2018, 338.316 € sipas nenit 39.2. Sipas vendimeve të kodit, vendimet gjyqësor kapitale 349.274 € Të gjitha këto pagesa që janë, shumica kanë qenë që deri në maj të vitit 2018, që i kemi bo pagesat, obligimet e viteve të kaluara. Janë do pagesa që edhe sivjet që i kemi pas do projekte do shërbime. Që nuk kemi mund me i pagua për shkak të mungesës së mjeteve. Edhe janë drejtuar të gjitha palët që kanë të drejtë, edhe me përmbarim edhe procedurë gjyqësore, apo me procedura direkt sipas nenit 39.2. Është e vërtetë që komuna duhet të angazhohet më së shumti që ti inkasoj të hyrat vetanake, që për me i realizuar edhe shërbimet edhe projektet, me programin që është i komunës në interes të qytetarëve. Unë prapë po ju them që kemi obligim të gjithë që deri në fund të vitit të paguajmë tatimet, obligimet ndaj komunës së Prizrenit. Se me ligjin e ri do të obligohemi me inkasua detyrueshëm. Edhe besoj që duhet të interesohemi edhe ne më shumë. E kam një qëllim që deri në fund të vitit së paku të tejkalojmë vitin 2017. Për shkak se planifikimi për sivjet është 8.100.000 € Sipas kushteve apo kriterëve, apo gjendjes faktike si është në komunën e Prizrenit. Nuk kemi mundësi të arrimë deri në 8.000.000 € Këtë shumë e ka caktua Ministria e Financave dhe ne obligohemi të realizojmë.

Ilir Baldedaj: Së pari drejtor nuk mora përgjigje rreth pyetjeve që ti bëra. Harrove, po nuk ke ardhur këtu për me harrua, por ke ardhur me na dhënë

Ilogari. E dyta po dua me e pyet kryesuesin, sinqerisht si kryetar i LVV-je, a je dakord, apo ndoshta që kuvendarët e kanë lëshua seancën dhe po e bojkotojnë. Që shpenzimet e buxhetit janë kundër shpenzime të këtyre buxhetit. A jeni pro këtyre shpenzimeve. Se sinqerisht është mirë me pas një opinion të juajin. Sepse keni qenë kreator i qebapëve.

Ertan Simitçi: Ilir kërkoj falje. Është e vërtetë që jemi për me dhënë sqarime, lidhur me mirëqenien sociale që pat një pyetje. Është e vërtetë që vitet e kaluara nuk e kemi pasur kodin. Se janë do shërbime të mirëqenies sociale që paguhen. Deri më tani nuk kemi pasur, prej vitit 2018 kemi fillua me inkasua. Ilir Baldedaj, pat për dokumentet blanko. Të gjitha këto dokumentet janë që vinë prej ministrive përkatëse. Janë do dokumente që vinë prej Ministrisë së Shëndetësisë, që ne i paguajmë të gjitha certifikatat, edhe obligohet komuna e Prizrenit me i pagua. Për kompjuterë, nuk e di sa kompjuterë janë marrë. Mirë është që drejtori Osmani, ai është për këtë përgjegjës. Me një kërkesë besoj që Osmani ju jep përgjigje.

Kryesuesi: Faleminderit. Ne vazhdojmë me pikën e radhës të fundit të rendit të ditës.

Pika e gjashtë:

Shqyrtim – diskutimi për propozimvendimin për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës pyjore.

Për këtë gjë e kemi të ftuar këtu drejtorin e Urbanizmit si sponsorizues të kësaj kërkesë. E ftojmë ta marr fjalën ta njoftoj Kuvendin, se për çka më konkretisht kemi të bëjmë.

Fatmir Memaj, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm: Në pyetjen e kuvendares së nderuar, nga radhët e opozitës, se pse është sjellë kjo lëndë në Kuvend për miratim. Arsyeja është sepse e parasheh ligji mbi ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Kërkesa bëhet nga ana ime, si drejtor i Urbanizmit, para jush. Në bazë të ligjit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ për këtë qëllim. Pala ka bërë kërkesë për ndërtimin e një vikend shtëpize në vendin e quajtur Gornje Sellë. Lokacioni pak më i përafërt është afër qendrës ku është Pro Credit Bank, që e ka një ndërtesë aty rrugës për Prevallë. Është njëra ndër kushtet e cila nevojitet për lëshimin e lejes. Gjithashtu ka edhe kushte tjera siç është aktvendimi nga drejtoria për Çështje Pronësoreshë-Juridike, për të drejtën e përparësisë, KED-sit, Hidroregjionit Jugor, PTK-së e tjera. Do më thënë edhe kjo është njëra ndër

pëlqimet. Po se pala e cila e siguron edhe këtë pëlqim nga ky Kuvend, atëherë mundemi me procedua më tutje. Për më tepër është çështje e Kuvendit a do ta miratoj apo do të gjejë arsyeje për mosmiratimin e këtij propozimvendimi. Unë jam i obliguar sipas ligjit me procedua lëndën para jush. Për shkak se është kategori e klasës së VI e tokës pyjore. Dhe sipas ligjit të klasës së VI-të ndërrimin e destinimit e bënë Kuvendi komunal. Ne patëm bisedë edhe më herët kryesuesin e grupit parlamentar të PDK-së, icili kërkoj njëfarë lloj mirëkuptimi që ne vetë me u marrë me këtë punë. Po ne deri sa s'kemi kompetenca me u marrë vetë me këtë punë, atëherë kompetenca i mbetet Kuvendit. Për më tepër nëse ju mendoni që duhet me delegua ndonjë kompetencë, është çështje e juaja. Po nëse e delegoni, nëse është ligjore me delegua kompetencën ju. Është pastaj përgjegjësi e Drejtorisë së Bujqësisë për me veprua për këtë lloj ndërrim të destinimit. Nëse keni pyetje shtesë, sa jam këtu mundem me ju sqarua.

Kastriot Krasniqi: Kjo parcelë a është park nacional drejtor.

Memaj: Jo, sipas informatave që kam nuk është park nacional.

Krasniqi: Interesohu pak më shumë drejtor se park nacional është.

Memaj: Oke, nëse ju mendoni se është park nacional edhe keni dëshmi, mundeni lirisht me refuzua.

Alush Shala: Në bazë të dokumenteve që na ka sjell drejtori, ajo është pronë private. Dhe për dy kategoritë e tokave të ndryshme vendim merr asambleja komunale. Dhe sipas asaj që na ka ofrua drejtori, po flasim gjithmonë edhe në dokumentin që e posedojmë tani, po edhe sqarimet që na ka dhënë në KPF. Unë mendoj, që është mirë për një qytetarë që respekton institucionin. Po mirë është edhe institucioni të merr vendim të drejtë. Mirë është edhe drejtori i Inspektorateve, besoj edhe ai i ka pa ato dokumente. Po edhe Kadastra, ta vërteton pronësinë, që është pronë private. Dhe Inspektorati më siguri ka qasje dhe duhet të ketë qasje. A ka shkelje, a ka ndonjë prishje. Mos ti përmendim edhe njëherë. A ka ku me qit kanalizimin, e gjithçka, se ka plot elemente tjera. Nëse i plotëson, po besoj që keni thënë ju drejtor. Unë personalisht jam për me ja mundësua qytetarit të bëjnë shtëpi, vikende apo çka dojnë që janë brenda rregullave.

Memaj: Unë e ceka edhe më herët. Në mesin e kushteve ndërtimore kompania e Hidroregjionit Jugor, e merre përgjegjësinë për furnizim me ujë edhe për çështjen e kanalizimit. Në rast se mendojnë që është e dëmshme, ata nuk e japin pëlqimin. Po në mesin e pëlqimeve që duhet me marr është edhe

kjo. Kjo është procedurë standarde. Unë nuk mundem me shmangë këtë procedurë. Njëra nder ato pëlqimet që nevojitet, nevojitet edhe pëlqimi i juaj për ndërrim të destnimit. E keni të cekur, është pronë private. E ke të cekur edhe në propozim. Është ngastër private, është pronësi private. Edhe kërkohet ndërrimi i destnimit për aq sa i nevojitet për ndërtimin e kësaj vikend shtëpize. Jo të tërë ngastrës.

Kastriot Krasniqi: Drejtor, sa i përket Hidroregjionit. Hidroregjioni nuk është në sistem. Zhupa komplet sipër nuk është në sistem. Nuk mundet mi dhënë pëlqim. Më së miri ti është me qua, qysh tha parafolësi Alush Shala, me qua Inspektoratin e këta tjerët. Me pru me një seancë tjetër. Më së miri kishte me qenë me shkua në vend të ngjarjes njëherë, tani me pru këtu.

Memaj: Tash kjo çështja me i end palët, me shkua tutje e këndeje. Unë nuk jam i interesuar dhe i obliguar palët pa nevojë mi end. Po Hidroregjioni është i autorizuar me dhënë pëlqim, nëse nuk ka pengesë. Shiko është në zonën kadastrale të fshatit Gornje Sellë. Edhe fshati Gornje Sellë bënë pjesë në komunën e Prizrenit. Komuna e Prizrenit e ka një kompani publike, e cila merret me menaxhimin e rrjetit të kanalizimeve dhe të ujësjellësit. Nëse ka ndonjë kompani tjetër, atëherë sigurisht që edhe ne do ta kishim dërgua te ajo kompani që me marrë pëlqimin.

Memnuna Ajdini: Ja tražim poajšnjenje. Dakle gde se nalazi lokacija. Da li ima izlaz na glavnom putu. Ako nema nema, onda tu su mogu e malverzacije. U smislu da je vlasnik ko je kupio. Otvara svoj sopstveni put u svoju režiju. Obzirom da mi u Župi imamo jako loše iskustva sa vlasnicima koji su kupili od privatnika, ili eventualno kupili od društvene imovine. Oni vrlo esto otvaraju puteve samostalno u društvenoj imovini. I pri tome taj put ne dozvoljavaju da korište meštani Župe. To su meštani u ovoj slu aju Gornje Sela, ili nekih drugih sela. Dakle vrši se uzurpacija društvene imovine. Ja smatram da ovo moramo malo bolje ispitati. Radi se o površini, koja je pozamašna. Nije to vikendica obi na, nego tu ima 150 metara kvadratnih. Od 350 metara kvadratnih, koje je u njegovo vlasništvo. Dakle i 150 metara kvadratnih, to je velika ku a. Nije to vikendica. Kakvok tipa e biti gradnja. Mi moramo znati. Obzirom da imamo velikih zloupotraba od takvih vlasnika. Uostalom ja sam dala jedan primer na ovoj sendici, gde je vlasnik restorana Panorama zloupotrebio društvenu imovinu. I zabranio upotrebu puteve koji ve bio postoje i i u kadastru je zaveden.

Memaj: Nëse ju kam kuptua drejtë, njëra ndër shqetësimet është edhe qasja në rrugë. Sa i përket qasjes në rrugë, ne kemi kërkuar pëlqim nga Ministria e Infrastrukturës. Pasi që rruga nëpër cilën duhet të qaset investitori i takon kompetencës së Ministrisë së Infrastrukturës, sepse është rruga Prizren-Prevallë. Sa i përket projektit është çështje e bashkëpunëtorit profesional, të cilët punojnë në Drejtorinë e Urbanizimit. Nuk është as çështje e imja se unë nuk jam arkitekt. Është çështje e bashkëpunëtorëve profesional, se sa gjejnë mundësi ligjore për me ja lejuar sipas të cilit duhet ta ndërtoj.

Ajdini: Radi se o nacionalnom parku. I znamo da je izgradnja objekata sa odre enim materialu. U ovom slu aju treba da se navedi kakav material e biti upotrebljen. Radi se o vikendici. Ali nije naglašeno kakva e biti. Kakva konstrukcija e biti. To trebamo ipak da se bolje upoznamo.

Memaj: Projekti i ka të gjitha ato elemente që po i cekni. Unë projektin nuk e kam me veti. Edhe nuk është çështja ime projektin me elaborua. Nëse i lejohet sigurisht që ka me bo. Mirëpo është në fazën e mbledhjes së pëlqimeve. Kërkohet vetëm ndërrim i destinimit. Nuk kërkohet kurrëgjë tjetër prej juve. Nëse ja lejoni, nëse s'ia lejoni është problem i juaji.

Sherife Balaj: Unë e përmenda këtë pikë edhe këtë shqetësimin tim për këtë destinimin e tokës të pylltarisë, për fushën në Gjonaj. Edhe është një interes publik, nuk është diçka privat sikur kjo pikë. Më 27.04.2018, klubi i futbollit prej Gjonajve ka bo kërkesë në Drejtorinë e Kulturës në komunën e Prizrenit, për një destinim të tillë. Edhe hala po presim. Do më thënë s'është e rëndësishme. Sipas drejtorit të Kulturës, thotë që boll keni qua para në Has, sa jeni kon dhjetë vjet në pushtet. Edhe më s'ka investime nëpër katunde. Qysh bre s'ka investime nëpër katunde kur është në interes të qytetarëve.

Kryesuesi: Ju lutëm rri në temë.

Balaj: Në temë jam. Mirëpo për këto rende të ditës, të cilat për çështje individuale, nuk po më duket e arsyeshme se s'po shoh material të bollshëm. Nuk e dimë a jemi në park nacional. A ka me bo një ndërtesë, a ka me shti material të fortë, beton, e plus sende të tjera. Kështu që mua s'po më duket e arsyeshme mjaftueshëm.

Haziz Hodaj: U prek klubi Drini i Bardhë. Unë jam kryetar i klubit Drini i Bardhë. Ta njoftoj Sherifen.

Kryesuesi: Haziz të lutëm, e kam bo një rend. Ta jap fjalën mandej.

Ilir Baldedaj: Unë së pari kisha kërkuar nga opozita që ta lëshon seancën, sepse nuk jemi këtu duke ua mbajtur kuorumin juve pushtetit. Sepse vet nuk i keni numrat dhe mendoni që opozita t'ua bëjë kuorumin. Ndërsa sa i përket kësaj çështje, nuk do ta mbështesim, sepse aty nuk ka as kanalizim, as infrastrukturë elementare për asgjë. E lëre më ta shohim se çfarë do të ndërtohet aty. Unë po kërkoj që opozita ta lëshon seancën. Insha Allah ju qohen prej gjumit ata kuvendarë. Ekzekutivi s'është kurrkund, kryetari s'është. Kjo është një lojë me ne si kuvendarë, dhe me gjithë qytetarët e Prizrenit.

Sinan Alija: Unë desha vetëm të bëjë dallimin. Më qenë se opozita u largua prej sallës. Është kërkesë e qytetarit të nderuar i cili ka një interesim të vetin të caktuar. Çka është pronë private ose çka është pronë publike ose çka është interes shtetëror. Këto dy gjëra s'po mundemi me bo dallimin. E drejta e pronës private është e drejtë e shenjtë, sa i përket të drejtave të tyre në raport me natyrën, ekologjinë, ambientin. Në raportin arkitektonik, përshtatjen, ato janë të përcaktuara po më duket edhe me drejtori përkatëse. Po ashtu kërkesa që ka qenë më herët e atij të nderuari qytetar për një biznes në pronën komunale për me shndërrua, si kadastër e di që ka qenë e kategorisë së V-të, të mos gaboj. Se kjo sa i përket të drejtës private. Sigurisht se ne nuk guxojmë aty fort me prek edhe me i lyp atij arsyetim se çka do me ndërtua ai aty. Se janë drejtoritë përkatëse. Sa i përket të drejtës së pronës publike, si ai raporti i atij zotërisë prej Mamushës, në rast se s'gaboj. Për një stallë që ka pas atje të bëjë 52 hektar. Ati më sa duket ju ka mundësua. Mund të bëhen edhe kërkesa tjera në qoftë se qytetarët kanë ide dhe rezonojnë për me zhvillua një biznes të caktuar. A do të ju lejohet edhe atyre tjerëve. A do të jetë asambleja në gjendje me marrë përgjegjës, që të ju jepet një e drejtë. Nëse ju ka bo atij e drejtë. A do të vazhdon edhe më tutje për kërkesat tjera të afaristëve ose të qytetarëve të caktuar. Sa i përket kësaj si pronë private. Neve na mbetet vetëm me delegua përgjegjësinë te drejtoritë përkatëse. Unë për vete, nuk e di pse kam të drejtë unë atë njeri me kufizua, me votën time. Që asnjë të drejtë as kushtetuese nuk më takon mua me kushtëzua ose me e diskriminua, për shkak se ai ka një vullnet të caktuar. Se është në fund të fundit me investime të veta. A sa i përket rregulloreve tjera, janë përcaktuese. Janë kategoritë edhe dikasteret e caktuar që duhet me i plotësua kushtet.

Haziz Hodaj: Unë ju kisha drejtua kësaj Sherife Balaj, që aq shumë po interesohet për Hasin. Me ja bo me dije se çfarë masakre investive kanë bo në kohën kur vetë kanë qenë. Dhe nuk e di qysh po kanë sy mu qua me bisedua

edhe me fol për Hasin. Singërisht nuk e kam të qartë. Nuk e kam të qartë se e dinë shumë mirë se çka ka ndodh atje. E dinë mirë se qysh kanë investua. Dhe nuk e kanë respektuar asnjë procedurë, asnjë tenderim, asnjë gjë. Edhe qohet e flasin tash edhe shesin patriotizëm, se ne kemi bo investime kapitale në Has. E di unë çfarë investime kapitale. Investime të turpshme kanë bo. Edhe qohet më flet për klubin futbollistik Drini i Bardhë. Ju kam thënë, ju ndihmoj për klubin me funksionuar edhe një ditë kishin bo kuvend. Pa prezencën time më kanë zgjedhë kryetari i klubit. Merre me mend tash Sherifja sot fliste më shumë për klubin Drini i Bardhë se sa unë. Edhe donë me shit patriotizëm edhe me këtë atje të hasjanët. Më thënë unë po kujdesëm për klubin Drini i Bardhë, e Hazizi nuk u kujdes që është pjesë e pozitës. Singërisht nuk e kam të qartë, se ku janë katandis këto diskutime. Edhe desha mi thënë, po ndoshta më sheh në televizor. Herët është bre për fushatë hala. Veç sa kemi startua me këtë pushtetin e ri. Prit mos të harxhohet energjia që në vitin e parë të qeverisjes. Në vitin e fundit mandej derdhe krejt energjinë që e ke edhe i fiton zgjedhjet. Çështja e destinimit është pronë private, edhe është krejt formale. Të gjitha ato tjerat që u cekën i takon Drejtorisë së Urbanizmit me profesionistët e vetë me marrë vendim mandej, me ja dhënë ose mos me ia dhënë lejen. Ndërrimi i destinimit është kompetencë ekskluzive e Kuvendit. Dhe ne duhet të marrim vendim. Të ja lejojmë ndërrimin a mos t'ia lejojmë. Për çështje tjera, a është në park nacional, a i plotëson kushtet tjera urbanistike, a ka kanalizim, a ka rrymë, a ka rrugë etj. etj. Le të merret Drejtoria përkatëse, sepse për ata paguhen njerëzit aty që i ka në shërbim. Ndërrimi i destinimit është çështje ekskluzive e Kuvendit. Dhe do duhej me marr vendim edhe opozita. Sepse edhe një njëri i këtyre, se nuk e di kush është s'më intereson personalisht ai që e ka kërkua. Po sigurisht që edhe ndonjë njeriu i këtyre kërkon një ndërrim destinimi, dhe prandaj duhet të merremi prapë me të.

Sinan Alija: Ajo kadastra që është bo, prona publike që i është dhënë atij biznesmeni, ka qenë e kategorisë të III-të, të V-të? A është e të njëjtës kategori, kjo po më intereson. S'po e di të kategoritë. Në qoftë se ju ka dhënë atij, pse mos me ju dhënë këtij, këtu ke.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të Kuvendit. Aktualisht jemi 13 anëtarë të Kuvendit në sallë dhe nuk ka kuorum për tu marrë vendim. Mbetet kjo për ndonjë mbledhje tjetër. Ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë mbledhje. Dhe mirupafshim në mbledhjen e radhës.

Përfundoi në orën 12:40.

Procesmbajtës;
Sehat Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi